Raport mbi të drejtat e njeriut në Kosovë - 2008
Zyra për demokraci, të drejta të njeriut dhe punë
Raportet e shtetit mbi praktikat e të drejtave të njeriut – 2008
25 shkurt 2009

Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia më 17 shkurt. Kosova ka rreth 2.2 milionë banorë. Misioni i administratës së përkohshme të OKB-së në Kosovë (UNMIK) administroi me Kosovën në bazë të Rezolutës 1244 të vitit 1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (KSKB) deri më 15 qershor, kur kushtetuta e vendit hyri në fuqi. Kushtetuta themelon një demokraci parlamentare dhe inkorporon konventat dhe traktatet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Zgjedhjet shumëpartiake në nëntor 2007 për Kuvend të Kosovës në përgjithësi pasqyruan vullnetin e votuesve. Para 17 shkurtit, Kosova administrohej nga autoriteti civil i UNMIK-ut, i drejtuar nga një përfaqësues special i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së (PSSP). Qeveria gradualisht mori përsipër përgjegjësitë në shumicën e sferave gjatë këtij viti. Me shpalljen e kushtetutës, në qershor, roli i UNMIK-ut në administrimin e Kosovës u zëvendësua nga mekanizma të tjerë ndërkombëtarë, të paraparë me planin e Ahtisaarit, përfshirë këtu Zyrën Civile Ndërkombëtare (ZNC) dhe Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX), i cili e zëvendësoi Policinë e UNMIK-ut më 9 dhjetor. Qeveria, autoritetet civile ndërkombëtare të UNMIK-ut dhe forca paqeruajtëse për Kosovën (KFOR), e autorizuar nga OKB-ja, dhe e udhëhequr nga NATO-ja, në përgjithësi mbajtën kontroll efikas ndaj forcave të sigurimit.

Qeveria dhe UNMIK-u në përgjithësi i respektuan të drejtat e njeriut; megjithatë, pati probleme në disa fusha, posaçërisht lidhur me bashkësitë pakicë. Më seriozet nga to ishin vdekjet dhe lëndimet nga mjetet e pashpërthyera ose minat tokësore; korrupsioni dhe ndërhyrja e qeverisë në forcat e sigurisë dhe gjyqësi; paraburgimi i gjatë dhe mungesa e procesit të drejtë gjyqësor; rastet e dhunës me motive politike dhe etnike; antipatia shoqërore ndaj serbëve dhe kishës ortodokse serbe; mungesa e përparimit në kthimin e personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre; korrupsioni i qeverisë; dhuna dhe diskriminimi i femrave; trafikimi i personave, posaçërisht i vajzave dhe i grave për shfrytëzim seksual; dhuna shoqërore, abuzimi dhe diskriminimi i bashkësive pakicë; diskriminimi shoqëror i personave me aftësi të kufizuara; abuzimi dhe diskriminimi i homoseksualëve; dhe puna e fëmijës në sektorin joformal.

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Seksioni 1 Respektimi i integritetit të personit, përfshirë këtu lirinë nga:

a. Privimi arbitrar ose i paligjshëm i jetës

Nuk pati raportime që qeveria, UNMIK-u, apo agjentët e tyre kryen vrasje arbitrare ose të paligjshme. Ndryshe nga vitet e mëparshme, forcat e UNMIK-ut nuk vranë asnjë individ gjatë demonstratave.

Më 4 prill, Human Rights Watch i shkroi Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Shqipërisë dhe u kërkoi ta hetonin trafikimin e supozuar të organeve të civilëve nga Kosova në Shqipëri gjatë konfliktit të vitit 1999 në Kosovë. Të dy qeveritë i hodhën poshtë këto pohime. Në pohimet e vitit 2004 thuhej se më 1999 trafikantët kidnapuan civilë nga Kosova dhe i sollën në Shqipëri, ku disa u vranë dhe organet e tyre u shitën. Në atë kohë, UNMIK-u dhe Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) kryen hetime paraprake lidhur me këtë çështje, që nuk rezultuan në veprime të mëtejme. Autoritetet shqiptare thanë se bashkëpunuan në ato

hetime. Në korrik, Këshilli i Evropës caktoi një raportues special për të raportuar mbi këto pohime. Në tetor, prokurorët shqiptarë u takuan me homologët e tyre serbë në Tiranë për të diskutuar për këtë çështje. Nuk mund të pajtoheshin për hapat e mëtejmë të përbashkët.

Gjatë këtij viti, autoritetet e UNMIK-ut kryen hetimet për rastin e forcave të sigurimit të UNMIK-ut që qëlluan dhe vranë dy protestues dhe plagosën rënd dy të tjerë me plumba gome gjatë një demonstrate të Lëvizjes Vetëvendosja në shkurt 2007, në të cilën demonstruesit u bënë të dhunshëm. Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi konkludoi se humbja e jetës ishte e pajustifikueshme dhe faktet ofruan dyshim të arsyeshëm të veprave penale ndër personelin e sigurimit që kishte shtënë plumba gome. Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi gjithashtu konkludoi se nuk kishte prova të mjaftueshme për të ngritur akuzë ndaj ndonjë polici të veçantë.

Pati raportime për sulme dhe kërcënime me motive politike ndaj personaliteteve politike e institucionale të shqiptarëve të Kosovës gjatë këtij viti.

Më 8 janar, prokurorët akuzuan Milliq Milliçeviqin, Millivoje Zdravkoviqin, Radojko Dunjiqin dhe Dushan Manjolloviqin për sulm kundër pjesëtarëve të sigurimit të PSSP-së Joachim Rücker dhe të komandantit të KFOR-it Xavier de Marnhac në Gorazhdec të Pejës në dhjetor 2007. Sipas raporteve të mediave, disa fshatarë serbë të Kosovës ishin të zemëruar që Rücker dhe de Marnhac kishin zgjedhur të takoheshin me dy serbë të Kosovës që punonin për Qeverinë e Kosovës, për të cilët sulmuesit besonin se nuk e përfaqësonin bashkësinë e gjerë. Nuk pati raportime për të lënduar.

Gjatë këtij viti pati raportime se dy veta vdiqën dhe tre u lënduan nga minat tokësore apo mjetet e pashpërthyera nga konflikti i vitit 1998-99.

Pati zhvillime lidhur me incidentin e shkurtit 2007 në të cilin u shti kundër Anton Berishës, shef i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, gjersa udhëtonte në magjistralen Prishtinë-Pejë. Më 22 prill, Gjykata e Qarkut e Prishtinës i vendosi të dyshuarit Agron Haradinaj, Mentor Qela, Agim Hoti, dhe Driton Spahiu në paraburgim. Policia gjithashtu arrestoi dhe më pas i liroi tre të dyshuar të tjerë për përfshirje në këtë incident. Gjykimi i katër të pandehurve vazhdoi deri në fund të vitit.

Nuk pati zhvillime lidhur me vrasjen më 2007 të policit të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) Avni Kosumi; hetimet e policisë vazhduan deri në fund të vitit.

Nuk pati zhvillime gjatë këtij viti lidhur me rastin e Hetem Sadri Rexhajt, që u vra në dhjetor 2006 në stacionin policor në Pejë. Gjithashtu nuk pati zhvillime në hetimin e vrasjeve në vijim që mund të kenë qenë me motive politike: vrasja më 2006 e Mark Oroshit, i cili dyshohej për vrasjen e Shaban Manajt, avokat dhe aktivist politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Istog, më 2001, apo vrasja më 2006 e serbit të Kosovës Dragan Popoviq, i cili u qëllua dhe u vra në shtëpinë e tij në komunën e Klinës etnikisht të përzier.

Më 17 prill, Gjykata e Qarkut në Prizren i shpalli Osman Zyberajn dhe Shyqeri Shalën fajtorë për vrasjen më 2005 të Hasan Rrustemit dhe tentim vrasjen e Nezim Rrustemit. Të dy viktimat ishin dëshmitarë të gjykimit në vazhdim e sipër të Selim Krasniqit, epror i Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), i akuzuar për krime lufte kundër civilëve shqiptarë të Kosovës në Kampin e Ndalimit në Drenoc të Prizrenit më 1998. Krasniqi dhe një i bashkëpandehur u shpallën fajtorë dhe u dënuan me nga shtatë vjet burg më 2006.

Më 6 qershor, Florim Ejupi u shpall fajtor për sulmin me bombë ndaj autobusit të "Nish Ekspresit" dhe u dënua me 40 vjet burg. Ejupi ishte paditur edhe më parë nën akuzat se ai dhe bashkëpunëtorët e tij kishin planifikuar dhe kryer sulmin me bombë më 2001 afër Podujevës, me ç'rast 11 serbë të Kosovës u vranë dhe 40 u plagosën.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje me motive politike; megjithatë, mijëra persona ende ishin të zhdukur që nga konflikti i vitit 1998-99, kufomat e të cilëve nuk ishin identifikuar apo nuk dihej për fatin e tyre.

Sipas Komitetit ndërkombëtar të kryqit të kuq (ICRC), në nëntor, 1,919 persona gjendeshin në listën e personave të zhdukur që nga konflikti i vitit 1998-99, prej të cilëve 70 për qind ishin shqiptarë të Kosovës dhe 30 për qind serbë të Kosovës dhe pakica të tjera.

Gjatë këtij viti, Ministria e Drejtësisë dhe Zyra për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore (ZPZHML) vazhduan identifikimin e trupave të pajetë të personave të zhdukur. EULEX-i u kyç në punën e tyre më 9 dhjetor. Që nga viti 2002, ZPZHML, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, kreu 642 operacione dhe zhvarrosje në terren, 71 prej të cilave ndodhën prej janarit deri në nëntor. Që nga viti 2002, ZPZHML zbuloi trupat e pajetë të mbi 3,800 personave të zhdukur dhe u përqendrua në identifikimin e 1,570 trupave të pajetë të zbuluara në Kosovë, bashkë me rreth 900 trupa të pajetë nga Serbia.

Nga fundi i nëntorit, 396 trupa të paidentifikuar ishin nën kujdesin e ZPZHML-së (354 trupa ishin zhvarrosur në Kosovë dhe 42 ishin transferuar nga Serbia). Deri në nëntor, ZPZHML pranoi 101 raporte pozitive të ADN-së, që përfaqësonin 54 individë të identifikueshëm. Gjatë të njëjtës periudhë, ZPZHML dhe Komisioni ndërkombëtar për persona të zhdukur punuan në identifikimin e 12 rasteve të personave të zhdukur për të cilët nuk kishte dhurues të mjaftueshëm të gjakut për të siguruar informata për krahasim. Të dhënat nga ADN-ja dhe metodat tradicionale u kombinuan për ta konfirmuar identifikimin e trupave të pajetë. Gjatë 11 muajve të parë të këtij viti, ZPZHML kreu 71 operacione në terren, zbuloi 60 trupa të pajetë të paidentifikuar dhe i transferoi në morg për autopsi dhe identifikim.

Më 2006, qeveria serbe transferoi grupin e fundit të kufomave të identifikuara të shqiptarëve të Kosovës nga konflikti i vitit 1998-99 të gjetura në varrezat masive në Serbi. Këto kufoma iu kthyen familjeve për varrim. Familjet e personave të zhdukur vazhduan të kërkonin nga qeveria serbe që t'u ofronte qasje në dokumentet që do të mund të tregonin për lokacionet e varrezave të tjera masive apo të vendeve ku trupat mund të kenë qenë djegur.

Zyrtarë nga Kosova dhe Serbia u takuan tri herë gjatë këtij viti në kuadër të grupit punues për persona të zhdukur, të kryesuar nga ICRC-ja dhe nën patronazhin e PSSP-së. Edhe pse një nëngrup punues për çështje të mjekësisë ligjore u takua tri herë gjatë këtij viti dhe palët mbajtën disa telekonferenca në çështje të mjekësisë ligjore, qindra trupa të pajetë mbetën të paidentifikuar në morgun e Prishtinës.

Sipas ICRC-së, në periudhën ndërmjet janarit dhe gushtit, ZPZHML identifikoi mbi 75 trupa të pajetë dhe ua dorëzoi familjeve, përfshirë këtu nëntë viktima nga bashkësitë pakicë. 41 ishin transferuar përmes ICRC-së nga Serbia në Kosovë; 16 ishin transferuar nga Kosova në Serbi (ishin zhvarrosur në Kosovë dhe u ishin dorëzuar familjeve në Serbi), dhe 98 ishin

transferuar brenda Kosovës (ishin zhvarrosur në Kosovë dhe u ishin dorëzuar familjeve në Kosovë).

c. Torturimi dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera të egra, çnjerëzore apo poshtëruese

Ligji dhe kushtetuta ndalojnë praktika të tilla. Ndryshe nga vitet e mëparshme, nuk pati raportime që qeveria, UNMIK-u (që mbajti autoritetin mbikëqyrës dhe ekzekutiv në funksione të policisë deri më 9 dhjetor), EULEX-i, apo KFOR-i (që ka autoritet të kufizuar për arrestim dhe ndalim) ishin të përfshirë në praktika të tilla.

Në prill 2007, një bastisje e udhëhequr nga SHPK-ja në komunën e Shtërpcës me shumicë serbe, e kryer vetëm nga policët shqiptarë, rezultoi në lëndimin e disa serbëve të dyshuar të Kosovës dhe në pohime të besueshme për përdorim të tepërt të forcës dhe sjellje të pavend. Si rrjedhojë, SHPK-ja filloi një hetim të brendshëm ndaj 11 policëve. SHPK-ja u lëshoi letra disiplinore pesë policëve dhe shfajësoi gjashtë policët e tjerë për keqbërje. Pas këtij incidenti, SHPK-ja filloi ta zbatonte një direktivë të re, që së paku një polic i SHPK-së që i takon grupit etnik të synuar nga operacioni policor të marrë pjesë në planifikim. Përveç kësaj, direktivat e reja kërkojnë që një polic që flet gjuhën e të dyshuarve të jetë i pranishëm tërë kohën për të përkthyer.

Kushtet e burgjeve dhe të qendrave të ndalimit

Burgjet dhe qendrat e ndalimit në përgjithësi i plotësonin standardet ndërkombëtare; dhe qeveria u lejoi vizita vëzhguesve të pavarur për të drejta të njeriut. Pati pohime për abuzim dhe keqtrajtim të të burgosurve gjatë këtij viti. Qendra e Kosovës për rehabilitimin e viktimave të torturës (QRVT), një OJQ që i vizitoi dhe monitoroi burgjet e Kosovës gjatë këtij viti, raportoi në dhjetor se stafi i Shërbimit Korrektues të Kosovës fizikisht dhe gojarisht i abuzonte të burgosurit në burgun e Dubravës. QRVT gjithashtu raportoi për pohime të tjera të keqtrajtimit në burgun e Lipjanit.

Në gusht 2007, një grup i personave të burgosur për terrorizëm, vrasje, tentim vrasje dhe vjedhje iku nga burgu i Dubravës. Policia më pas arrestoi tre të arratisur. Policia maqedonase më pas vrau tre të arratisur të tjerë afër Tetovës, Maqedoni, në nëntor 2007. Më 25 mars, SHPK-ja konfirmoi arrestimin e tre të arratisurve të tjerë. Dy të arratisur mbetën në liri në fund të vitit.

UNMIK-u raportoi se procedurat disiplinore ishin ngritur kundër pjesëtarëve të SHKK-së gjatë këtij viti. Deri më 30 nëntor, 22 punonjës të SHKK-së ishin pushuar nga puna, tre të tjerë morën qortime me shkrim, dhe një punonjësi iu ul grada.

Gjatë këtij viti, Burgu i Dubravës kishte mesatarisht 744 të burgosur në muaj, kurse kapaciteti i tij i plotë ishte për 1,104 të burgosur. Burgu i Dubravës dhe i Lipjanit dhe gjashtë qendra të ndalimit punuan gjatë këtij viti, përfshirë këtu qendrën e saporinovuar të ndalimit në Lipjan.

Gjatë këtij viti, UNMIK-u përfundoi bartjen e përgjegjësive për administrimin e burgjeve të Kosovës tek SHKK-ja, që vepron nën Ministrinë e Drejtësisë. SHKK-ja udhëhoqi punët ditore në burgun e Dubravës, me përjashtim të sektorit 32 për të burgosur të rrezikut të lartë, që mbeti nën mbikëqyrje ndërkombëtare. UNMIK-u mbajti një rol të kufizuar në monitorim dhe mentorim të burgjeve dhe hoqi dorë nga autoriteti i vet mëparshëm për ta marrë kontrollin ndaj sistemit të burgjeve gjatë emergjencave.

UNMIK-u u lejoi ICRC-së dhe ombudspersonit vizita dhe monitorim të burgjeve dhe qendrave të ndalimit. Në shkurt 2007, Ministria e Drejtësisë i lejoi Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), një OJQ vendëse, qasje të plotë në të gjitha burgjet, qendrat e ndalimit dhe qendrat korrektuese. KMDLNJ ishte ankuar më parë se i ishte mohuar qasja në disa raste. KMDLNJ, bashkë me ICRC-në, ombusdpersonin dhe Qendrën e Kosovës për rehabilitimin e të mbijetuarve të torturës e inspektuan burgun e Dubravës gjatë këtij viti.

d. Arrestimi ose ndalimi arbitrar

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar, dhe qeveria, UNMIK-u, dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa.

Roli i policisë dhe i aparatit të sigurimit

Forcat vendëse të sigurisë përfshinin SHPK-në dhe TMK-në, një organizatë civile për reagime emergjente që funksiononte nën autoritetin e PSSP-së. Deri në fillim të dhjetorit, UNMIK-u mbajti autoritetin mbikëqyrës dhe intervenues ndaj policisë, por vazhdoi t'i bartte kompetencat dhe funksionet policore tek SHPK-ja. Më 9 dhjetor, EULEX-i mori përsipër mandatin e UNMIK-ut për t'i monitoruar, mentoruar dhe këshilluar institucionet lokale të gjyqësisë dhe të zbatimit të ligjit. EULEX-i gjithashtu posedonte autoritet të kufizuar ekzekutiv në fushat që përfshinin krimet e luftës, mbrojtjen e dëshmitarëve, Njësinë Hetuese Financiare, dhe policinë ndërkombëtare.

Deri në fillim të dhjetorit, një komisar ndërkombëtar i policisë i drejtonte policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në. Pas 9 dhjetorit, shefi i komponentit të EULEX-it për polici mori përgjegjësinë për monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e SHPK-së. Anëtarët e pakicave etnike përbënin 15.5 për qind të 7,050 policëve të SHPK-së në fund të vitit; 10 për qind e policëve të SHPK-së ishin serbë të Kosovës. Pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt, 347 policë serbë të Kosovës filluan ta bojkotonin SHPK-në në shenjë proteste, kryesisht me urdhër të autoriteteve serbe; megjithatë, Ministria e Punëve të Brendshme vazhdoi t'i paguante policët që bojkotonin. Rreth 15 për qind e policëve të SHPK-së ishin femra.

Autoriteti ekzekutiv mbi SHPK-në ndahej ndërmjet qeverisë, UNMIK-ut dhe EULEX-it. SHPK-ja ishte përgjegjëse për të gjitha operacionet ditore të policisë në të gjitha rajonet, përveç rajoneve veriore të Zubin Potokut, Zveçanit, Leposaviqit dhe Mitrovicës. Në ato rajone, njësitë serbe të SHPK-së punonin drejtpërdrejt për UNMIK-un deri më 9 dhjetor, kur EULEX-i e zëvendësoi UNMIK-un. Njësitë e specializuara policore për krime lufte, antiterrorizëm dhe shpëtim të pengjeve, dhe programi për mbrojtjen e dëshmitarëve mbetën të plotësuara me policë ndërkombëtarë të OKB-së dhe vepronin pavarësisht nga SHPK-ja për shkak të ndjeshmërisë së atyre funksioneve. Njësitë për zbulim penal dhe krim të organizuar vepronin bashkërisht. Policia dhe gjyqësia ndërkombëtare kanë diskrecion të gjerë për të intervenuar në ndonjë çështje të veçantë penale. Si çështje praktike, shumica e detyrave dhe përgjegjësive policore ishin në duar të SHPK-së.

Korrupsioni dhe ndikimi i qeverisë mbetën problem ndër forcat e sigurimit. Në shtator, p.sh., policia arrestoi shtatë pjesëtarë të Shërbimit Doganor për shkak të përfshirjes së tyre në një rrjet që kontrabandonte farmaceutikë për në vend. Nuk pati informata të tjera në dispozicion në fund të vitit.

Inspektorati i Policisë i Kosovës (IPK) vepron si organ i pavarur në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i dizajnuar për ta mbështetur efikasitetin e policisë, për ta mbajtur policinë përgjegjëse për veprimet e veta, dhe për t'i hetuar shkeljet e supozuara të ligjit. IPK ia dërgon rezultatet e hetimeve që zbulojnë shkeljet Komisionit policor për emërime të larta dhe disiplinë (KPELD) për masa të tjera të mundshme. Gjatë këtij viti, IPK hetoi 2,024 raste aktive, prej të cilave 789 ishin të bazuara në ankesa nga qytetarët, dhe 1,235 ishin nga vetë SHPK-ja. Prej atyre rasteve, 168 ishin në hetim e sipër, 323 u konsideruan të pabazuara, 482 hetime u përfunduan dhe iu dërguan KPELD-it, dhe 781 iu dorëzuan Njësisë për Standarde Profesionale (NJSP), që përqendrohej në hetimin dhe dënimin e kundërvajtjeve të policëve. 270 rastet e tjera ishin në hetim e sipër. 43 për qind e shkeljeve të rënda ishin për sjellje të pavend të policëve, ndërsa 30 për qind për mosbindje. 9 për qind e hetimeve përfshinin pohimet për përdorim të pavend të forcës, 5 për qind u përqendruan në pohime për vepra penale, dhe 1.5 për qind kishin të bënin me ankesa për korrupsion.

NJSP merret me hetimin dhe dënimin e kundërvajtjeve të policëve dhe drejtohet nga SHPK-ja. Gjatë këtij viti, NJSP hapi 989 raste, pjesa më e madhe e tyre kishte të bënte me mungesa pa leje nga puna, braktisje të zonës së detyrës, dhe dëmtim apo humbje të pronës policore. Në fund të vitit, 716 prej këtyre rasteve u përfunduan, 500 u konsideruan të bazuara, 212 u konsideruan të pabazuara, dhe katër mbetën të hapura. NJSP mbylli një rast pa masa hetuese për shkak të dorëheqjes së policit të akuzuar. Sanksionet silleshin prej pushimit nga puna deri në suspendim të përkohshëm apo trajnim të obligueshëm. Deri në dhjetor, 273 raste ishin ende në hetim e sipër; në rastet që kishin të bënin me shkeljen e kodit penal, shumë nëpunës u suspenduan përkohësisht dhe pritnin vendimin e gjykatës.

Arrestimi dhe ndalimi

Policia në përgjithësi arrestimet i bënte haptas duke përdorur urdhër arrestin e lëshuar nga gjykatësi apo prokurori; megjithatë, në disa raste, arrestimet kryheshin nga policët e maskuar apo sekretë. Sipas ligjit, arrestimet duhet të bazohen në urdhrat e prokurorit, dhe të arrestuarit duhet të sillen para gjykatësit brenda 72 orëve. Shumica e arrestimeve të këtij viti u bënë nga SHPK-ja. Nuk pati raportime që SHPK-ja e abuzoi rregullin 72-orësh; autoritetet në përgjithësi i akuzonin të arrestuarit brenda gjashtë orëve apo i lironin. Të arrestuarit kanë të drejtë të informohen, në gjuhën që e kuptojnë, për shkakun e arrestimit të tyre; të heshtin dhe të mos u përgjigjen pyetjeve, përveç për identitetin e tyre; për ndihmë falas të përkthyesit; për avokat mbrojtës dhe për sigurim të avokatit mbrojtës nëse nuk mund ta paguajnë; për trajtim mjekësor dhe psikiatrik; dhe për ta informuar ndonjë anëtar të familjes. SHPK-ja dhe Policia e UNMIK-ut në përgjithësi i respektonin këto të drejta në praktikë.

Nën rrethana të jashtëzakonshme, KFOR-i mund t'i arrestojë dhe ndalojë individët pa urdhër arrest. Komandanti i KFOR-it mund t'i ndalojë individët për 72 orë, dhe ta vazhdojë atë edhe për 72 orë. Pas 144 orësh, KFOR-i duhet ta lirojë të ndaluarin. Nuk pati raportime që KFOR-i kishte arrestuar persona pa urdhër arrest gjatë këtij viti.

SHPK-ja dhe Policia e UNMIK-ut mund t'i mbajnë individët deri në 72 orë pa urdhër të gjykatës. Gjykata mund t'i mbajë individët në paraburgim 30 ditë nga dita e arrestimit, por mund ta vazhdojë ndalimin deri në gjithsej 18 muaj. Ligji lejon arrestin shtëpiak, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit, dhe përdorimin e gjerë të dorëzanisë si alternativa ndaj paraburgimit, por këto masa u zbatuan vetëm në disa raste. Të pandehurit gjithashtu mund të ankoheshin për paraburgimin e tyre

Ndalimet e gjata, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbetën problem. Ligji parashikon që gjykatësi mund ta imponojë këtë masë të jashtëzakonshme vetëm kur masat e rëndomta, si arresti shtëpiak, nuk mjaftojnë për ta siguruar praninë e të pandehurit gjatë procedurës penale dhe për të mundësuar administrim të duhur të procedurës penale. Në praktikë, gjykatësit zakonisht e përdornin paraburgimin pa treguar justifikim të mbështetur në prova.

Shtyrjet e gjykimeve shkaktoheshin nga faktorë që përfshinin paaftësinë e gjyqësorit dhe korrupsionin.

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta, korniza e mëparshme kushtetuese, dhe qeveria parashikojnë gjyqësi të pavarur; megjithatë, gjyqësia vendëse nganjëherë i nënshtrohej anësisë dhe ndikimit të jashtëm dhe nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë. Pati raportime të besueshme për korrupsion brenda gjyqësisë vendëse, dhe sistemi i gjykatave ishte joefikas.

Deri më 9 dhjetor, autoritetin ligjor e mbante UNMIK-u, sipas Rezolutës 1244 të KSKB-së. Autoritetet e UNMIK-ut për Polici dhe Drejtësi mbanin përgjegjësinë ekzekutive për sistemin gjyqësor, por punonin me gjykatësit dhe prokurorët vendës; UNMIK-u vazhdoi t'ua kalonte disa kompetenca të rezervuara Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, derisa nuk u zëvendësua nga EULEX-i. Qeveria e Serbisë vazhdoi ta drejtonte një sistem paralel të palejuar të gjyqësisë në enklavat serbe në Kosovë dhe në komunat me shumicë serbe. Në protestat e marsit kundër pavarësisë së Kosovës, protestuesit serbë të Kosovës detyruan mbylljen e gjykatës komunale dhe Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe të gjykatave komunale në Leposaviq e Zubin Potok. Më 3 tetor, UNMIK-u njoftoi për rihapjen e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Më 9 dhjetor, EULEX-i vendosi tre gjykatës, tre prokurorë dhe tre zyrtarë ligjorë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Gjykatat komunale mbetën të mbyllura në fund të vitit.

Sistemi i gjykatave përfshin një Gjykatë Supreme, pesë gjykata të qarkut, përfshirë këtu një gjykatë ekonomike, 25 gjykata komunale, 25 gjykata për kundërvajtje, dhe një gjykatë të apelit për kundërvajtje. Në fund të vitit kishte tetë gjykatës ndërkombëtarë dhe shtatë prokurorë ndërkombëtarë të emëruar nga UNMIK-u. Qeveria financonte një zyrë qendrore të prokurorisë publike, pesë prokurori të qarkut dhe shtatë prokurori komunale. Prokuroria Speciale e Kosovës vazhdoi të punonte nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut dhe përfshinte gjashtë prokurorë specialë të përqendruar në krime të rënda, përfshirë këtu trafikimin e personave, korrupsionin, dhe antiterrorizmin.

Ndonëse ligji parashikon që rastet e rënda të gjykohen nga një panel prej dy gjykatësve profesionalë dhe tre gjykatësve porotë, një rregullore e UNMIK-ut i autorizon prokurorët ndërkombëtarë që t'i gjykojnë rastet e natyrës së ndjeshme etnike ose politike, para një paneli prej tre gjykatësve ndërkombëtarë. Që kur ia filluan punës, në vitin 2000, prokurorët ndërkombëtarë kanë përfunduar 513 prej 727 rasteve që u ishin caktuar atyre.

Gjatë këtij viti, UNMIK-u ndau Njësinë e vet për Inspektim Gjyqësor në dy njësi të veçanta: Zyra për Këshillim Disiplinor (ZKD) dhe Njësia për Auditim Gjyqësor (NJAGJ). ZKD ishte përgjegjëse për hetimin e aktiviteteve të gjykatësve, prokurorëve dhe gjykatësve porotë, dhe për paraqitjen e rasteve të sjelljes së keqe para Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK). NJAGJ analizoi dhe vlerësoi punën e gjykatave dhe të prokurorive publike, dhe i dërgoi raporte dhe

rekomandime KGJK-së, Ministrisë së Drejtësisë, dhe Kuvendit. Që nga viti 2001, ZKD ka shqyrtuar gjithsej 2,482 ankesa, përfshirë këtu 399 gjatë këtij viti. Prej këtyre 399 ankesave, njësia refuzoi 221 raste dhe përfundoi 50 hetime. Gjatë këtij viti, ZKD-ja ia drejtoi 40 raste KGJK-së, që kishte gjithsej 59 raste që pritnin të zgjidheshin në fund të vitit. KGJK mbajti një seancë disiplinore para Komisionit Gjyqësor Disiplinor. Gjatë këtij viti, NJAGJ përfundoi tri raporte të auditimit.

Procedurat e gjykimit

Gjykimet janë publike, dhe ligji parashikon të drejtën e të pandehurve të jenë të pranishëm në gjykimet e veta, të përballen me dëshmitarë, t'i shohin dëshmitë, dhe të kenë përfaqësim ligjor. Përfaqësimi mund të sigurohet në shpenzime publike nëse është e nevojshme; megjithatë, kjo procedurë rrallë përdorej në praktikë. Të pandehurit konsiderohen të pafajshëm derisa të mos shpallen fajtorë, dhe kanë të drejtë të ankohen. Gjykimet dëgjohen nga panelet e përbëra nga gjykatësit profesionalë dhe gjykatësit porotë; nuk ka gjykime me juri.

Më 2007, qeveria themeloi një Komision për ndihmë juridike, një agjenci e pavarur qeveritare që u ofron ndihmë juridike falas personave me të ardhura të ulëta. Komisioni filloi punën në janar. Që nga 30 qershori, komisioni u kishte ofruar ndihmë juridike 538 personave përmes pesë zyrave rajonale për ndihmë juridike. Komisioni u ofroi ndihmë 272 personave në çështje administrative, 207 personave në çështje civile, dhe 59 personave në çështje penale. Prej të gjithë personave që kanë marrë ndihmë, 207 (38 për qind) ishin femra dhe 48 (9 për qind) pakica, përfshirë këtu anëtarët e bashkësisë rome, turke, boshnjake, serbe dhe egjiptiane. Komisioni ia drejtoi 79 raste (15 për qind) avokatëve të shoqatës së avokatëve të Kosovës për përfaqësim të financuar ligjor në gjykata, ndërsa zyrtarët për ndihmë juridike i shqyrtuan rastet e mbetura. Llojet më të rëndomta të kontesteve ligjore përfshinin rastet e ndihmave sociale dhe të pensionit, rastet pronësore dhe të drejtës familjare, dhe kontestet trashëgimore.

Sektori për integrimin e gjyqësisë, i drejtuar nga Ministria e Drejtësisë, vazhdoi t'i shqyrtonte problemet e sistemit gjyqësor që ndikonin në pakica. Përveç kësaj, Ministria drejtonte 11 zyra ndërlidhëse të gjykatave për t'u ndihmuar bashkësive pakicë në zonat e Kosovës me shumicë serbe, duke i shoqëruar anëtarët e pakicave në gjykata, duke paraqitur dokumente në gjykata në emër të tyre, dhe duke siguruar informata dhe ndihmë ligjore për refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV). Si reagim ndaj kritikave të mëhershme nga ekspertët ligjorë dhe vëzhguesit e të drejtave të njeriut për mungesë të drejtësisë në gjykimet penale ku përfshiheshin pakicat etnike, gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë--e jo shqiptarë të Kosovës--i shqyrtonin dhe gjykonin rastet ku përfshiheshin serbët e Kosovës.

Sistemi i drejtësisë i Kosovës dhe TPNJ vazhduan t'i identifikonin dhe dënonin autorët e krimeve të luftës nga konflikti i vitit 1998-99; megjithatë, shumë raste mbetën të pazgjidhura.

Më 27 maj, policia e Prishtinës arrestoi Gjelosh Krasniqin, njërin prej katër personave të përfshirë në zhdukjen e policit Mark Luli më 1999. Ai u akuzua për krime lufte, kidnapim, vjedhje dhe vrasje. Prokurorët pohuan që Krasniqi dhe tre të dyshuar të tjerë të panjohur e të armatosur, të veshur në uniforma të KFOR-it gjerman, hynë në shtëpinë e Lulit dhe e urdhëruan t'i shoqëronte; Luli nuk u pa më kurrë. Krasniqi mbeti në burgim në pritje të gjykimit në fund të vitit.

Më 10 tetor, një prokuror ndërkombëtar ngriti padi për krime lufte kundër Momçillo Jovanoviqit në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Jovanoviqi akuzohej për vrasje dhe shkelje të tjera të ligjeve të luftës për incidentet që ndodhën më 1998 dhe 1999 në fshatin Katund i Ri. Procedura të tjera gjyqësore priteshin nga fundi i vitit.

Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë

Nuk pati raportime që qeveria, KFOR-i, apo UNMIK-u mbanin të burgosur apo të arrestuar politikë gjatë këtij viti.

Procedurat dhe mjetet juridike civile

Sipas një raporti të OSBE-së të vitit 2006, ndërhyrja e autoriteteve komunale dhe e Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi e pengoi pavarësinë e gjyqësorit në çështje civile. OSBE-ja citoi raste në të cilat autoritetet komunale haptazi penguan procedurat gjyqësore, bënë presion në gjykatës në rastet në të cilat autoritetet ishin palë, dhe ndikuan në palët e treta për t'i penguar gjykatat nga ushtrimi i autoritetit të vet. OSBE-ja gjithashtu raportoi se Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi i udhëzoi gjykatësit të mos i shqyrtonin ankesat për kompensim për dëme pronësore të shkaktuara nga KFOR-i, UNMIK-u, apo komunat. Gjatë këtij viti, OSBE-ja raportoi se ishte arritur pak përparim në këtë aspekt, por jo i mjaftueshëm, për ta ulur numrin e rasteve të pazgjidhura. Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi pohoi se nuk kishte ushtruar ankesa të tilla për kompensim sepse sfidat logjistike të ankesave të tilla ishin të pakapërcyeshme. Ai gjithashtu pohoi se numri i madh i ankesave lidhur me pronën do të mund ta pengonte punën e gjykatave, ta shtonte numrin edhe kështu të madh të rasteve të pazgjidhura, dhe të kërkonte planifikim e koordinim të posaçëm, pasi do të ishte e domosdoshme të sigurohej përcjellje për një numër të madh të paditësve serbë të Kosovës. Në korrik 2007, OSBE-ja raportoi që UNMIK-u dhe autoritetet komunale ndërhynë pavend në pavarësinë e gjyqësorit në shitjen e propozuar të pronës në mëhallën e romëve në rajonin e Mitrovicës.

Në nëntor, Komisioni i Bashkësive Evropiane raportoi se sistemi gjyqësor i Kosovës mbeti i dobët në të gjitha nivelet. Raporti i Komisionit citonte besimin e ulët të publikut në sistemin e drejtësisë, si dhe ekzistimin e vazhdueshëm të tri burimeve paralele të legjislacionit: ligjin e ish-Jugosllavisë, rregulloret e UNMIK-ut, dhe ligjin e Kosovës si probleme të posaçme. Komisioni gjithashtu vuri në pah se numri i madh i rasteve të pazgjidhura gjyqësore mbeti problem serioz.

Nuk pati raportime për vështirësi në zbatimin e urdhrave të gjykatave që rezultonin nga kontestet civile. Megjithatë, sipas një studimi të vitit 2006, vetëm 14 për qind e rasteve të pazgjidhura që ndikonin në rendin civil rezultuan nga kontestet civile; 69 për qind e rasteve të tilla kishin të bënin me mbledhjen e borxhit nga kompanitë e shërbimeve publike.

Rikthimi i pronës

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) ishte përgjegjëse për zgjidhjen e ankesave për pronën rezidenciale, komerciale dhe bujqësore që dilnin nga konfliktit i Kosovës.

Deri në dhjetor, AKP kishte 4,146 prona nën administrim, 3,173 me kërkesën e pretenduesit të suksesshëm, dhe 973 në bazë të ndërhyrjeve *ex-officio* (për shkak të detyrës) nga Komisioni për çështje pronësore dhe banesore (KÇPB, agjenci paraardhëse e AKP-së). Prej këtyre

rasteve, 135 ishin kërkesa për riposedim. Deri në dhjetor, agjencia kishte pranuar gjithsej 40,065 ankesa: 35,955 për pronë bujqësore, 1,011 për pronë komerciale, dhe 3,099 për pronë rezidenciale. Serbët e Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës vazhduan t'i zinin pronat e shqiptarëve, ndërsa shqiptarët në pjesën jugore ua zinin dhe ua mohonin serbëve qasjen në pronën e tyre.

Mandati i AKP-së përfshin mbikëqyrjen e dhënies me qira të pronave specifike, të braktisura në Kosovë, pjesa më e madhe e të cilave u takonin serbëve të Kosovës. Për këtë qëllim, agjencia menaxhoi një skemë të dhënies me qira për pronat që i kishte nën administrim, duke u mundësuar mbajtësve të pronave të merrnin të ardhura nga qiraja e pronës. Gjithsej 897 prona ishin të dhëna me qira në fund të vitit, 158 prej të cilave ishin dhënë me qira *ex-officio*. AKP mbodhi përafërsisht 653,562 euro ($892,852) nga qiraja përmes këtij programi.

AKP nuk qe në gjendje t'i zbatonte 10 vendimet e mbetura të KÇPB-së (prej rreth gjithsej 30,000 vendimeve) për pronat që gjendeshin në Mitrovicën veriore, për shkak të brengave nga autoritetet se përpjekjet për zbatim do të mund të çonin në dhunë. Vështirësi të njëjta e penguan zbatimin e skemës për dhënie me qira në Mitrovicën veriore.

Më 15 maj, PSSP rithemeloi KÇPB-në në kuadër të AKP-së për t'i shqyrtuar kërkesat për rishqyrtim në rastet në të cilat kërkesa origjinale ishte mohuar. KÇPB zgjidhi 12 kërkesa për rishqyrtim që buronin nga mandati i vjetër i DÇPB-së në takimet e veta të qershorit dhe gushtit. Përveç kësaj, Komisioni i Kosovës për ankesa pronësore, një dorë kuazi-gjyqësore e AKP-së, që vepron nën mandatin e AKP-së, zgjidhi 14,088 ankesa deri në fund të gushtit.

Në qershor, ligji u ndryshua për ta prurë AKP-në nën kontroll të qeverisë; më pas qeveria serbe ia ndërpreu AKP-së qasjen në të dhënat kadastrore dhe në të dhënat e tjera pronësore që gjendeshin në Serbi. Qeveria serbe njoftoi se pezullimi do të vazhdonte derisa UNMIK-u ta ripohonte autoritetin e vet ndaj AKP-së. Pezullimi i operacioneve të AKP-së në Serbi e reduktoi dukshëm mundësinë e agjencisë për ta përmbushur mandatin e vet, pasi 90 për qind e paditësve gjendeshin jashtë vendit. Pezullimi pengoi qasjen në arkivat përkatëse dhe shkaktoi vonesa në gjykimin e ankesave.

Numri i pazgjidhur i ankesave pronësore në gjykata komunale mbeti i lartë, rreth 21,000 në fund të këtij viti, që paraqitnin pothuaj vetëm ankesa financiare të serbëve të Kosovës për dëme të lidhura me luftën.

f. Ndërhyrja arbitrare në intimitet, familje, shtëpi, apo korrespondencë

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë veprime të tilla, dhe qeveria, UNMIK-u, dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa në praktikë. Forcat e KFOR-it i ndihmonin policisë civile të UNMIK-ut dhe SHPK-së në kryerjen e kontrollimeve për të dyshuar të rrezikut të lartë dhe në mënyrë të pavarur kontrollonin pronën private për armë, pa urdhër të gjykatës, duke u bazuar në autoritetin paqeruajtës të Rezolutës 1244 të KSKB-së.

Seksioni 2 Respektimi i lirive civile, përfshirë këtu:

a. Lirinë e fjalës dhe të shtypit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e fjalës dhe të shtypit, dhe qeveria e UNMIK-u në përgjithësi i respektuan këto të drejta në praktikë. Megjithatë, pati raportime për kërcënim

ndaj gazetarëve, përfshirë këtu kërcënimin nga zyrtarët në sektorin publik e qeveritar, dhe nga politikanët e bizneset. Mediat gjithashtu hasën në vështirësi dhe pengesa me rastin e marrjes së informatave nga institucionet qeveritare dhe publike. Ligji mbi mediat transmetuese ndalon fjalimin urrejtës dhe fjalimin që nxit dhunë etnike.

Individët në përgjithësi mund t'i kritikonin autoritetet publikisht ose privatisht pa reprezalje.

Sipas Shoqatës së gazetarëve profesionistë të Kosovës, vështirësitë financiare të mediave bënë që pavarësia redaksionale dhe profesionalizmi gazetaresk t'i nënshtroheshin ndikimit dhe presionit të jashtëm. Disa gazeta ishin financiarisht të pavarura apo punonin përmes donacioneve ndihma dhe kështu ishin në gjendje të zhvillonin politika redaksionale të pavarura nga interesat afariste apo politike. Megjithatë, disa gazeta të tjera mbështeteshin në financim nga grupe afariste apo të interesit politik, të cilat siguronin para në shkëmbim për raportim pozitiv. Gjatë këtij viti, nuk pati raportime që qeveria apo UNMIK-u ushtruan presion apo ndikuan në mediat e shkruara të pavarura.

Mediat e shkruara vetërregulloheshin nga një kod i sjelljes për mediat e shkruara i miratuar nga Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës, organizatë e përbërë nga redaktorë dhe botues të mediave të shkruara. Bordi i Këshillit për ankesa mund të imponojë gjoba për shkelje të kodit të sjelljes, përfshirë këtu gjobat deri në 2,000 euro ($2,600) për shkelje të rënda, si fjalimi urrejtës dhe shpifja.

Gjatë këtij viti, Kosova kishte 113 transmetues të licencuar (45 prej tyre transmetonin në gjuhët e pakicave), dhe këta transmetues shprehnin një gamë të gjerë të pikëpamjeve. Prej 68 transmetuesve, gjuhë kryesore e të cilëve ishte shqipja, tri stacione publike televizive të grupit të RTK-së (TV, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky), të financuara nga qeveria, gjithashtu transmetonin çdo ditë në gjuhët e pakicave.

Gazetarët raportuan për presion nga politikanët dhe krimi i organizuar, i cili shpesh rezultonte në forma të tërthorta të censurimit. Disa gazetarë përmbaheshin nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre personale. Gazetarëve nganjëherë u ofrohej kompensim financiar në shkëmbim për raportim pozitiv apo për heqje dorë nga ndonjë hetim; disa u kërcënuan gojarisht nga zyrtarë qeveritarë dhe kriminelë të dyshuar për gjoja raportim negativ ndaj tyre. Sipas redaktorëve, agjencitë qeveritare i tërhiqnin reklamat e rregullta nga gazetat që kishin raportuar në mënyrë kritike për to.

Transmetuesi publik, Radiotelevizioni i Kosovës (RTK), mbikëqyrej drejtpërsëdrejti nga Kuvendi, dhe buxheti i tij kontrollohej nga Ministria e Financave. Ligji parashikon rregullimin e përmbajtjes së programit të RTK-së dhe kërkon që së paku 15 për qind e kohës së programit të RTK-së, përfshirë këtu kohën qendrore, t'u kushtohet bashkësive pakicë në gjuhën e tyre përkatëse në baza proporcionale.

Komisioni i pavarur për media zbatoi rregulloret dhe imponoi kodet e sjelljes që i drejtonin mediat transmetuese. Komisioni është organ i përhershëm i mbikëqyrur nga një këshill drejtues 7-anëtarësh që përfshin dy anëtarë ndërkombëtarë.

Më 14 maj, Këshilli i Komisionit të pavarur për media shprehu shqetësim lidhur me një kërkesë nga zyra e kryeministrit drejtuar transmetuesve kombëtarë, e cila kërkonte që ta transmetonin dhe ritransmetonin një fjalim të 16 prillit në kohë të caktuara dhe në mënyrë të

koordinuar. Këshilli theksoi se toni i kërkesës, me udhëzime të caktuara, do të mund të interpretohej vetëm si presion i qeverisë ndaj mediave të pavarura.

Pas një kritike publike, gazeta *Infropress* ndërpreu botimin e listave të serbëve të Kosovës që ishin pjesëtarë të ushtrisë jugosllave gjatë konfliktit të vitit 1998-99.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, nuk pati raportim për grindje ndërmjet gazetarëve dhe policisë. Megjithatë, Shoqata e gazetarëve profesionistë të Kosovës raportoi për 13 raste të abuzimit të lirisë së shtypit gjatë këtij viti. Aty përfshiheshin kërcënimet verbale ndaj gazetarëve dhe agjencive të tyre nga subjektet e prekura nga raportimi negativ i mediave, dhe presioni për të mos botuar materiale dhe artikuj të caktuar.

Gjatë këtij viti pati disa incidente të dhunës apo ngacmimit të drejtuara kundër mediave.

Më 6 janar, një grup prej mbi 20 serbëve të Kosovës sulmoi ekipin katër-anëtarësh të KTV-së që ishte duke xhiruar kremtimin e krishtlindjes ortodokse afër enklavës së serbëve të Kosovës në Graçanicë. Sulmi ndodhi kur grupi mësoi që anëtarët e ekipit ishin shqiptarë të Kosovës. Grupi e pengoi kameramanin gjersa ishte duke xhiruar dhe e goditi dy herë në kokë. Policia intervenoi në emër të ekipit dhe i përcolli jashtë fshatit. Rasti iu paraqit policisë, por nuk pati zhvillime të mëtejshme lidhur me këtë rast.

Më 21 shkurt, një kameraman vendës, i angazhuar nga kanali televiziv Top Channel me seli në Tiranë, u sulmua gjersa xhironte një protestë kundër pavarësisë në Mitrovicën veriore. Një grup i protestuesve, i udhëhequr nga një person i maskuar, iu afrua kameramanit, e rrahu, dhe ia shkatërroi kamerën para syve të SHPK-së dhe Policisë së UNMIK-ut. Pas këtij incidenti, një zëdhënës i policisë u tha reporterëve se i vinte keq për sulmin ndaj kameramanit, duke shtuar se i këshilloi reporterët dhe kameramanin të qëndronin larg turmës. Rasti iu paraqit policisë, por nuk pati të arrestuar.

Më 6 qershor, anëtarët e ekipit të Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) u kërcënuan dhe sulmuan nga personeli i sigurimit në ndërtesën e KGJK-së. Ekipi televiziv ishte duke përgatitur një storje mbi faturat e papaguara të rrymës nga gjykatat vendëse kur një roje e sigurimit ia përdrodhi dorën kameramanit, duke dëmtuar kamerën, dhe e mbajti kameramanin një orë brenda në ndërtesë. Roja e akuzoi ekipin se përpiqej tinëzisht ta xhironte ndërtesën. Nuk pati zhvillime të mëtejshme lidhur me këtë rast deri në fund të vitit.

Nuk pati zhvillime në këto raste të vitit 2007: sulmi në mars 2007 ndaj reporterit të *Lajmit* Enis Veliu; dhe djegia në shtator e shtëpisë së gazetarit Milaim Zeka, i cili kishte shkruar raporte për rastet kontroverse, përfshirë këtu vrasjet e profilit të lartë dhe korrupsionin.

Liria e internetit

Qeveria, UNMIK-u, apo KFOR-i nuk e kufizonin qasjen në internet, dhe nuk pati raportime që qeveria i vëzhgonte e-mailat apo bisedat në internet. Individët dhe grupet mund të angazhoheshin në shprehje paqësore të mendimeve përmes internetit, përfshirë këtu e-mailat. Në shtator, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit raportoi se rreth 23 për qind e qytetarëve e përdornin përditë internetin.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

Qeveria, UNMIK-u, apo KFOR-i nuk e kufizonin lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

b. Liria e grumbullimit paqësor dhe grupimit

Liria e grumbullimit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e grumbullimit, dhe qeveria, UNMIK-u, dhe KFOR-i në përgjithësi e respektuan këtë të drejtë në praktikë. Një rregullore e UNMIK-ut kërkonte që organizatorët e demonstratave ta njoftonin policinë 48 orë më parë për qëllime të koordinimit.

Më 19 shkurt, protestues serbë nga Kosova dhe Serbia sulmuan Portën 1 dhe Portën 31, vendkalime kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për të protestuar kundër shpalljes së pavarësisë. Pasi protestuesit u larguan, njësitë e KFOR-it rimorën kontrollin e portave dhe i mbyllën vendkalimet kufitare për 24 orë. Më 20 shkurt, autoritetet i rihapën portat pa praninë e doganierëve, por me prani të UNMIK-ut, KFOR-it dhe SHPK-së. Nga fundi i vitit, doganierët e EULEX-it filluan kryerjen e detyrave të kufizuara doganore në ato vende.

Më 22 shkurt, një grup i serbëve të Kosovës në Mitrovicën veriore protestoi kundër shpalljes së pavarësisë dhe misionit të EULEX-it duke gjuajtur fishekzjarre dhe gurë kundër policëve të stacionuar në anën veriore të urës së Ibrit. Turma u shpërnda pas protestës dy-orëshe.

Më 25 shkurt, rezervistët e ushtrisë serbe, që protestonin kundër pavarësisë së Kosovës, lënduan 19 pjesëtarë të SHPK-së duke i gjuajtur me gurë në Portën 4, vendkalim kufitar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Policia rihapi këtë vendkalim të nesërmen.

SHPK-ja përdori forcën në disa raste për t'i shpërndarë demonstratat dhe rrahu demonstruesit gjatë arrestimit.

Më 14 mars, protestuesit serbë të Kosovës ia mësynë ndërtesës së gjykatës së qarkut dhe komunale në Mitrovicën veriore, duke depërtuar me forcë përmes kordonit prej 45 policëve. Më 17 mars, Policia e UNMIK-ut, e mbështetur nga KFOR-i, rimori ndërtesën e gjykatës duke përdorur gaz lotsjellës dhe plumba gome. Gjatë këtij operacioni, 47 pjesëtarë të UNMIK-ut u lënduan, dhe Ihor Kynal, polic ndërkombëtar nga Ukraina, u vra nga një granatë dore e hedhur nga një protestues i paidentifikuar. Gjatë kësaj përleshjeje u lënduan dy policë serbë të SHPK-së, që merrnin pjesë në protestë.

Liria e grupimit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e grupimit, dhe qeveria, UNMIK-u, dhe KFOR-i në përgjithësi e respektuan këtë të drejtë në praktikë.

Misioni i OSBE-së në Kosovë rregullisht i regjistronte partitë politike nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut, dhe Ministria e Shërbimeve Publike i regjistronte OJQ-të. Pas pavarësisë, kjo kompetencë iu kalua Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

c. Liria e fesë

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e fesë, dhe qeveria e UNMIK-u në përgjithësi e respektuan këtë të drejtë në praktikë. Kushtetuta inkorporon konventa ndërkombëtare mbi të

drejtat e njeriut dhe përfshin dispozita që e mbrojnë lirinë e fesë dhe e ndalojnë diskriminimin e bazuar në fe.

Nuk ka rregullore specifike për licencimin e grupeve fetare; megjithatë, organizatat fetare duhet të regjistrohen si OJQ në UNMIK dhe në Ministrinë e Shërbimeve Publike për të blerë pronë ose për të marrë mjete financiare nga UNMIK-u apo organizatat e tjera ndërkombëtare. Grupet fetare ankoheshin se statusi i OJQ-së nuk e pasqyronte në mënyrë adekuate karakterin e tyre fetar, dhe Kisha protestante evangjeliste refuzoi të regjistrohej si OJQ.

Në mbledhjen e 5 qershorit, kuvendi komunal i Deçanit unanimisht refuzoi një vendim të PSSP-së, që përkrahte pronësinë e manastirit ndaj pronës së kontestuar në atë rajon dhe pritnin vendimin e gjykatës.

Në përputhje me një ligj të vitit 2002, i cili kërkon që institucionet publike të arsimit të përmbahen nga udhëzimet fetare apo aktivitetet e tjera që mbështesin ndonjë fe specifike, Ministria e Arsimit ndaloi mbajtjen e shamive. Ministria vazhdoi ta zbatonte këtë ndalesë, posaçërisht në shkolla ku veshja e uniformës ishte e detyrueshme, përkundër një mendimi të vitit 2004, të lëshuar nga ombudspersoni, se ai rregull duhet të zbatohet vetëm për mësimdhënës e nëpunës të shkollës, e jo për nxënës.

Më 26 shkurt, ombusdpersoni mori një ankesë nga një nxënëse e një shkolle të mesme në komunën e Vitisë se drejtori i kishte urdhëruar të mos vinte në shkollë me shami. Ombusdpersoni kërkoi që Ministria e Arsimit ta lejonte nxënësen ta vijonte mësimin me shami, dhe më 1 shtator, nxënësja filloi ta vijonte mësimin me shami. Gjatë këtij viti, dy femra gjithashtu iu ankuan ombusdpersonit se konkurruan për postin e mësimdhënëses në dy shkolla të mesme, por nuk u pranuan sepse mbanin shami. Në të dy rastet, ombusdpersoni i këshilloi ankueset ta paraqitnin rastin në gjykatë.

Grupet protestante vazhduan të raportonin se përjetonin diskriminim në qasje në media, posaçërisht nga RTK-ja. Kisha protestante evangjeliste në Kosovë, e njohur si Bashkësia e Popullit të Zotit, raportoi më 2006 se komuna e Deçanit, duke cituar reagime negative nga qytetarët lokalë, nuk i kishte dhënë leje për ta ndërtuar një objekt kishtar në tokën që kisha e kishte blerë më herët. Në fund të vitit, rasti mbeti të zgjidhej në Gjykatën Supreme.

Ndërsa disa kisha protestante ishin plaçkitur gjatë periudhës që mbulohet nga ky raportim, udhëheqësit e bashkësive nuk i konsideronin këto incidente të motivuara nga diskriminimi fetar. Megjithatë, protestantët individualë pohuan diskriminim verbal të drejtuar kundër tyre.

Bashkësia islame vazhdoi të pohonte se refuzimi i UNMIK-ut për frekuenca për një radiostacion islamik dhe mbyllja e një salle për falje në Bibliotekën Kombëtare përbënin shkelje të lirisë së fesë.

Abuzimi dhe diskriminimi shoqëror

Dhuna shoqërore shënoi rënie, por tensionet ndërmjet bashkësive etnike mbetën të larta, posaçërisht pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt.

Brengat e sigurisë vazhduan të ndikonin në bashkësinë serbe të Kosovës dhe në lirinë e tyre për t'u falur. Disa serbë të Kosovës pohuan se nuk ishin në gjendje të udhëtonin lirisht për ta ushtruar besimin e tyre.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, nuk pati raportime për incidente të hedhjes së gurëve dhe për sulme të tjera kundër klerikëve ortodoksë serbë gjersa udhëtonin jashtë manastireve të tyre. Megjithatë, pelegrinët që udhëtonin me autobus nga Serbia për të marrë pjesë në shërbime në manastirin e Deçanit shpesh gjuheshin me gurë, zakonisht nga fëmijët. Në komunat perëndimore të Pejës, Deçanit, Gjakovës, Istogut, Klinës, Skenderajt dhe Mitrovicës jugore, klerikët kërkuan përcjellje dhe KFOR-i ua siguroi atë. Klerikët theksuan se nuk mund t'i vizitonin anëtarët e kishës në perëndim (ku edhe gjenden vendet më të rëndësishme të shenjta ortodokse serbe) pa përcjellje, dhe anëtarët i cituan kërcënimet për sigurinë e tyre si pengesa për mundësinë e tyre për t'i vizituar vendet e shenjta. Murgjit e murgeshat në disa manastire gjoja nuk i shfrytëzonin disa pjesë të pronave të manastireve--shpesh tokën jashtë mureve të manastirit--për shkak të brengave të sigurisë.

Gjatë këtij viti, prokurorët vendosën të ushtronin padi kundër një shqiptari nga komuna e Zveçanit, i cili e kërcënoi një murgeshë ortodokse serbe nga manastiri i Sokolicës në korrik 2007. Gjykimi pritej të mbahej nga fundi i vitit.

Nuk pati zhvillime të reja në një rast të vitit 2006 në të cilin sulmues të panjohur shtinë në veturën që e ngiste prifti ortodoks serb Sërxhan Stankoviq në komunën e Zveçanit. UNMIK-u akuzoi një polic serb të SHPK-së lidhur me këtë incident. Rasti iu dorëzua një prokurori ndërkombëtar.

Gjatë këtij viti pati raste të shumta të vandalizmit dhe vjedhjes të drejtuara kundër pronës së kishës ortodokse serbe. Shumë raste përfshinin vjedhje të objekteve të punuara nga metalet e çmuara, ndërsa të tjerat përfshinin vandalizmin, shpesh të kishave të sapondërtuara.

Në fillim të vitit, SHPK-ja miratoi procedura të reja operative për të siguruar mbrojtje më të madhe për objektet fetare e kulturore ortodokse serbe. Si pjesë e kësaj përpjekjeje, qeveria ndau 50,000 euro ($65,000) për ta financuar zgjerimin dhe përmirësimin e mbrojtjes së SHPK-së, përfshirë këtu rojat private të sigurimit, kamerat, dhe ndriçimin në objektet më të cenueshme.

Më 25 shkurt, Jeton Mulaj, për të cilin dyshohej të kishte shtënë me mortajë dore në manastirin e Deçanit në mars 2007, vullnetarisht iu dorëzua policisë. Prokurori special ngriti padi kundër tij më 19 mars; më 18 shtator, Gjykata e Qarkut në Pejë e shpalli Mulajn fajtor për posedim të paligjshëm të armëve dhe dëmtim të monumentit të mbrojtur, dhe e dënoi me 3.5 vjet burg.

Më 1 mars, katër persona të panjohur vodhën kambanën nga kisha ortodokse serbe në Novakë, Prizren. SHPK-ja më pas e gjeti kambanën në një pyll disa qindra metra larg kishës. Policia nuk arrestoi askënd, dhe hetimet vazhduan deri në fund të vitit.

Më 5 korrik, në Kaçanik, Ferizaj, KFOR-i i raportoi policisë se persona të panjohur e kishin dëmtuar derën e hyrjes së kishës në Kaçanik; hetimet vazhduan deri në fund të vitit.

Nuk pati zhvillime të mëtejshme në incidentin e shkurtit 2007, në të cilin persona të panjohur dëmtuan interierin e kishës ortodokse në fshatin Mire, dhe vodhën rreth 30,000 dinarë serbë ($560), ose në rastin e marsit 2007 në të cilin persona të panjohur vandalizuan kishën e Shën Gjonit në Pejë.

Kisha ortodokse serbe shprehte brengosje për gjendjen e hapësirës së gjelbër të parkut kryesor të Gjakovës, për një pjesë të parkut që kisha e konsideron të veten. Në fund të vitit, diskutimet ishin duke u zhvilluar ndërmjet palëve të ndryshme të përfshira për ta zgjidhur këtë çështje.

Komisioni për zbatimin e rindërtimit (KZR), i financuar nga qeveria, përfundoi renovimet e gjera në 19 prej 34 objekteve fetare ortodokse serbe të dëmtuara gjatë trazirave të marsit 2004. Këtu përfshihej ndërtimi shtesë në disa objekte të identifikuara më parë, si dhe në disa objekte të reja, përfshirë këtu kishën e Shën Andrisë në Podujevë dhe kishën e Shën Pjetrit dhe Polit në Istog. Gjatë këtij viti, përparimi në projektet e KZR-së vonohej për shkaqe që lidheshin me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Megjithatë, më 16 shtator, kisha ortodokse serbe pranoi çelësat e dy objekteve të rindërtuara kishtare në Prizren, të rezidencës zyrtare të peshkopit dhe të shkollës ortodokse për priftërinj.

Gjatë këtij viti, myslimanët e Kosovës raportuan për incidente të shumta të drejtuara kundër bashkësisë së tyre, përfshirë këtu vjedhjen, vandalizmin dhe kërcënimet. Më 22 prill, p.sh., policët e SHPK-së, gjatë një patrullimi të zakonshëm në Gjilan, zbuluan se rreth 30 gurë varresh myslimane ishin dëmtuar në një varrezë lokale. Më 17 qershor, policia arrestoi dy të dyshuar. Rasti iu dërgua zyrës së prokurorit.

Më 26 qershor, serbë dhe romë të Kosovës u përleshën me shqiptarë të Kosovës në fshatin Berivojc të komunës së Kamenicës, ku pritej të fillonte puna për ndërtimin e një xhamie. Vendi i propozuar për ndërtimin e xhamisë gjendej në pjesën serbe të fshatit të përzier etnikisht, dhe bashkësia serbe tradicionalisht e kishte shfrytëzuar këtë tokë për tubime. Ndërtimi i propozuar nuk iu përmbajt procedurave ligjore të dizajnuara për ta siguruar pëlqimin e bashkësisë për ndërtim në tokën ku ajo bashkësi jeton.

Nuk pati raportime për akte antisemitike. Rreth 40 individë nga dy familje në Prizren kishin ca zanafillë hebraike, por nuk pati as sinagoga as institucione hebraike në Kosovë, përveç një varreze të vogël në Prishtinë.

Nuk pati zhvillime në rastin e gushtit 2007 në të cilin 14 gurë të varrezave hebraike ishin dëmtuar me qëllim.

Për diskutim më të hollësishëm, shih *Raportin ndërkombëtar të vitit 2008 mbi lirinë e fesë:* www.state.gov/g/drl/irf/rpt.

d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur brenda vendit, mbrojtja e refugjatëve, dhe e personave pa shtetësi

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e lëvizjes brenda vendit, udhëtimin jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin, dhe qeveria e UNMIK-u në përgjithësi i respektuan këto të drejta; megjithatë, tensionet ndëretnike dhe brengat e vërteta e të perceptuara të sigurisë e kufizonin lirinë e lëvizjes në praktikë. Gjatë këtij viti, qeveria, UNMIK-u dhe KFOR-i në përgjithësi mbështetën mbrojtjen e këtyre të drejtave për bashkësitë pakicë, në krahasim me vitin e kaluar. Qeveria bashkëpunoi me Zyrën e Komisariatit të Lartë OKB-së për Refugjatë (UNHCR) dhe me organizata të tjera humanitare për t'u ofruar mbrojtje dhe ndihmë personave të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve, refugjatëve që ktheheshin, azilkërkuesve, personave pa shtetësi dhe personave të tjerë të interesuar.

Policia vazhdoi ta vlerësonte situatën e sigurisë si stabile, por delikate. Policisë nuk iu raportuan krime që kishin të bënin me lirinë e lëvizjes. Megjithatë, anëtarët e të gjitha bashkësive etnike vazhduan të qëndronin kryesisht brenda apo të udhëtonin ndërmjet zonave në të cilat grupi i tyre përbënte shumicën. Hedhja e gurëve dhe forma të tjera të kërcënimit vazhduan të ndikonin në serbët e Kosovës gjersa udhëtonin jashtë zonave me shumicë serbe.

Gjatë këtij viti pate sulme kundër automjeteve që bartnin serbë dhe pakica të tjera etnike. Më 25 janar, p.sh., SHPK-ja raportoi se të rinj shqiptarë të Kosovës gjuajtën me gurë veturën që e ngiste një serb i Kosovës që jetonte në Gjilan. Të dyshuarit ikën nga vendi i ngjarjes. Më 1 shkurt, persona të maskuar e të armatosur ndalën një autobus që rregullisht bartte serbë të Kosovës për në Serbi afër Podujevës dhe i kërkuan 20,000 euro ($26,000). Të dyshuarit i morën çelësat e autobusit. Policia më pas e arrestoi një shqiptar të Kosovës. Hetimet e policisë vazhduan deri në fund të vitit. Më 5 korrik, SHPK-ja raportoi se pesë apo gjashtë të rinj shqiptarë të Kosovës në fshatin Suhodoll në Mitrovicë gjuajtën me gurë veturën që e ngiste një serb i Kosovës. SHPK-ja raportoi se policia i kishte paralajmëruar prindërit e të miturve.

Nuk pati zhvillime në rastin e tetorit 2007 në të cilin autobusi që bartte një grup të serbëve nga Kosova dhe Serbia u gjuajt me gurë gjersa udhëtonte në drejtim të manastirit të Deçanit.

Nuk pati zhvillime në rastin e nëntorit 2007 në të cilin persona të panjohur gjuajtën me gurë autobusin që transportonte 30 profesorë dhe studentë nga Shkolla Teologjike e Varshavës për Priftërinj për në manastirin e Zoçishtës gjersa ishte i parkuar në mes të një fshati me shumicë shqiptare.

Incidentet sporadike të dhunës dhe të kërcënimit që synonin pakicat vazhduan ta kufizonin lirinë e lëvizjes për shqiptarët në Kosovën veriore. Qeveria dhe UNMIK-u i shtuan përpjekjet për ta lehtësuar udhëtimin e pakicave, por rreziqet e vërteta dhe të perceptuara i frenonin shumë pakica që të udhëtonin jashtë lagjes së tyre, posaçërisht pasi vendi shpalli pavarësinë.

Më 28 shkurt, banorët shqiptarë të Kosovës të fshatrave të Leposaviqit ua dërguan një letër autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare përmes të cilës kërkonin përcjelljen e policisë për minibusin e tyre gjersa i transportonin banorët për në Mitrovicë dhe nga Mitrovica. Banorët thanë se nuk ndiheshin të sigurt të udhëtonin jashtë fshatrave të tyre nëpër zonat me shumicë serbe pa mbrojtjen e policisë.

Gjatë këtij viti, UNMIK-u ndërpreu programin që më parë u ofronte targa të Kosovës pa pagesë serbëve të Kosovës që i kishin regjistruar automjetet e veta në Serbi. Në praktikë, serbët që udhëtonin në veri të lumit Ibër në Mitrovicën veriore zakonisht i hiqnin targat e Kosovës dhe qarkullonin pa to në zonat veriore të vendit. Personat që udhëtonin për në Serbi i hiqnin targat e Kosovës në kufirin serb, dhe policia kufitare u lëshonte targa të përkohshme serbe.

Gjatë këtij viti pati incidente që kishin në shënjestër infrastrukturën që shfrytëzohej nga pakicat. Më 6 mars, p.sh., serbët e Kosovës i raportuan policisë në Gjilan se persona të panjohur kishin shkatërruar dhe vjedhur pjesë të një ure metalike për këmbësorë në një fshat serb. Policia identifikoi katër të dyshuar shqiptarë të Kosovës dhe arrestoi tyre prej tyre. Hetimet vazhduan deri në fund të vitit. Më 26 qershor, një këmbësor zbuloi një mjet të pashpërthyer afër hekurudhës në fshatin Kaçanik i Vjetër të Ferizajt. Më 7 korrik, një kalimtar zbuloi një mjet shpërthyes nën një urë hekurudhore në Mitrovicë.

Nuk pati zhvillime në këto raste të vitit 2007: zbulimi, në mars, nga gjuetarët i një granate të pashpërthyer afër një transmetuesi në Mitrovicë; zbulimi, në prill, i një i mjeti shpërthyes në një urë në Gjilan; dhe zbulimi i një mjeti të pashpërthyer nën një urë në fshatin Vërbovc në Gjilan. Nuk pati zhvillime as në incidentet e vitit 2007 në komunën e Leposaviqit në të cilat mjetet shpërthyese ishin vendosur përgjatë rrugës që shpie për në fshatrat shqiptare Koshtovë, Bistricë, dhe Cerajë.

Më 3 mars, agjencia serbe e lajmeve RTS raportoi se Hekurudhat e Serbisë morën kontrollin mbi infrastrukturën hekurudhore në Kosovën veriore pas nëntë vjet menaxhimi nga UNMIK-u. Kryetari i bordit të Hekurudhave të Serbisë, Branisllav Ristivojeviq, tha se ky hap do të ofronte cilësi më të lartë të transportit sesa të hekurudhave të UNMIK-ut, duke shtuar se shërbimi do të rifillonte sapo hekurudhat t'i përmbushin standardet e Hekurudhave të Serbisë. Të njëjtën ditë, serbët e Kosovës në fshatin Leshak penguan qarkullimin e trenit për të protestuar kundër pavarësisë vendit. Më 4 mars, KFOR-i ndali trenin që qarkullonte nga Fushë Kosova për në Leshak. Shërbimi hekurudhor nuk u rivendos deri në fund të vitit.

Qeveria e rregullonte lëvizjen brenda Kosovës dhe jashtë saj. Ligji parashikon që zyra qendrore e regjistrimit civil mund t'i lëshojë dokumente të udhëtimit cilitdo individ të regjistruar si banor i Kosovës, dhe zyra rregullisht lëshonte dokumente të tilla në praktikë. Më 23 korrik, UNMIK-u konfirmoi se më nuk do t'u lëshonte qytetarëve të Kosovës dokumente të UNMIK-ut për udhëtim. Qeveria filloi lëshimin a pasaportave të Kosovës më 30 korrik.

Ligji ndalon dëbimin me forcë, dhe autoritetet nuk e përdorën atë.

Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV)

Sipas UNHCR-së, rreth 205,855 persona nga Kosova mbetën të zhvendosur në Serbi dhe 16,077 në Mal të Zi si rrjedhojë e konfliktit të vitit 1998-99. Prej 4,100 personave të zhvendosur nga trazirat më 2004, nja 1,200 mbetën të zhvendosur. 19,978 persona ishin të zhvendosur brenda Kosovës, 52 për qind e tyre ishin serbë të Kosovës, dhe 38 për qind shqiptarë të Kosovës.

Për shkak të shpalljes së pavarësisë së vendit, shumë pak veta u kthyen gjatë këtij viti. Ndërmjet janarit dhe nëntorit, UNHCR-ja regjistroi vetëm 533 persona të kthyer, shumë më pak se më 2007, kur u kthyen 1,815 veta, apo më 2006, kur u kthyen 1,669 veta. Numri më i madh të kthyerve ishte nga Serbia (323), pastaj nga Mali i Zi (85) dhe Maqedonia (36), ndërsa 15 veta u kthyen nga të gjitha vendet e tjera. 74 veta u kthyen nga zhvendosja brenda Kosovës. Shumica e të kthyerve u përqendruan në rajonin e Pejës dhe të Prishtinës. Ndonëse qeveritë komunale në përgjithësi i mbështetën kthimet, pengesat mbetën për serbët e kthyer të Kosovës.

Prej vitit 2000 e deri në nëntor ishin kthyer gjithsej 18,527 anëtarë të pakicave. Serbët përbënin rreth 28 për qind të të kthyerve gjatë këtij viti, krahasuar me 32 për qind më 2007. Romët (përfshirë këtu ashkalinjtë dhe egjiptianët) vazhduan të ktheheshin, dhe përbënin 48 për qind të numrit të përgjithshëm të të kthyerve, krahasuar me 49 për qind më 2007. Në Mitrovicë, serbët në veri dhe shqiptarët në jug vazhduan ta zinin në mënyrë të paligjshme pronën e njëri-tjetrit, duke i penguar kthimet e mundshme.

Që nga gushti, 37 familje rome (114 persona) mbetën në kampin për PZHBV në Llugë, të ndotur me plumb. Osterode, një objekt për trajtim mjekësor, gjithashtu në Mitrovicën veriore,

strehonte 98 familje (395 persona) që u zhvendosën nga kampi i Llugës dhe dy kampe të tjera të ndotura më 2006.

UNMIK-u vazhdoi të shënonte përparim të ngadalshëm në rindërtimin e mëhallës së romëve në Mitrovicën jugore, të shkatërruar më 1999 nga shqiptarët e Kosovës. Personat e zhvendosur filluan të kthehen në këtë mëhallë më 2006; nga fundi i vitit 2007 ishin kthyer 368 banorë--307 romë, 59 ashkalinj, dhe dy serbë.

Mbrojtja e refugjatëve

Ligji parashikon dhënien e statusit të azilantit dhe të refugjatit sipas Konventës së vitit 1951 lidhur me statusin e refugjatëve apo të Protokollit të saj të vitit 1967. Ligji mbi azilin hyri në fuqi më 15 qershor; megjithatë, rregulloret për zbatimin e këtij ligji nuk u miratuan deri në fund të vitit. Gjatë këtij viti, UNHCR-ja ndihmoi Departamentin e sapoformuar për Kufij, Azil dhe Migrim në ndërtimin e kapacitetit të vet për të gjykuar pohime, për të ofruar trajnim për policinë kufitare, për të ndihmuar në identifikimin e personave që kanë nevojë për mbrojtje në pikat e hyrjes, dhe për ta penguar dëbimin.

Në praktikë, qeveria dhe UNMIK-i siguronin mbrojtje kundër dëbimit apo kthimit të refugjatëve në vendin ku jeta apo liria e tyre do të kërcënohej.

Seksioni 3 Respektimi i të drejtave politike: e drejta e qytetarëve për ta ndërruar qeverinë e tyre

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë të drejtën e qytetarëve për ta ndërruar qeverinë e tyre në mënyrë paqësore, dhe ata e ushtruan këtë të drejtë në praktikë përmes zgjedhjeve periodike, të lira e të drejta, në bazë të votimit të përgjithshëm.

Vendi shpalli pavarësinë më 17 shkurt. Gjatë këtij viti, autoritetet vendëse gradualisht morën përsipër autoritetin dhe përgjegjësitë në shumicën e fushave të qeverisjes. Ligji parashikon një Kuvend 120-anëtarësh, i cili ka autoritet ta zgjedhë presidentin, kryeministrin, ministrat e tjerë dhe zyrtarët e qeverisë.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe vendës konstatuan se zgjedhjet e nëntorit 2007 për Kuvend të Kosovës në përgjithësi pasqyruan vullnetin e votuesve, ndonëse pak serbë të Kosovës morën pjesë në to, kryesisht për shkak të presionit të qeverisë serbe për t'i bojkotuar zgjedhjet. Nuk u raportuan parregullsi të mëdha. Kosova kishte një sistem shumëpartiak të dominuar nga pesë parti shqiptare me disa parti e koalicione të pakicave.

Ligji parashikon që individët mund ta propozojnë veten si kandidatë të partive të tyre, të cilat duhet të mbajnë zgjedhje të brendshme, të hapura e transparente, për t'i zgjedhur listat e kandidatëve. Lidhja partiake luante rol të rëndësishëm në qasje në shërbime qeveritare e sociale dhe në mundësi për punësim. Marrëveshjet tradicionale shoqërore dhe besnikëritë klanore gjithashtu luanin rol të rëndësishëm, ndonëse jozyrtar, në organizatat politike.

38 femra ishin në Kuvendin 120-anëtarësh. Ligji kërkon që femrat ta zënë çdo të tretin vend në listën e kandidatëve të secilës parti politike. Nuk pati asnjë femër në kryesinë 8-anëtarëshe

të Kuvendit, dhe vetëm dy femra ishin ministre dhe tri zëvendësministre. Femrat përbënin 31.6 për qind të përfaqësuesve të zgjedhur komunalë.

Pas zgjedhjeve të nëntorit 2007, 24 anëtarë të pakicave etnike ishin në Kuvendin 120-anëtarësh, përfshirë këtu 10 serbë dhe 14 anëtarë të grupeve të tjera, ku përfshihen turqit, boshnjakët, goranët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët. Tre ministra nga pakicat--dy serbë e një boshnjak--dhe katër zëvendësministra--dy serbë e dy boshnjakë--ishin në qeveri. Një boshnjak, një turk, dhe një përfaqësues i bashkësisë rome, ashkalike dhe egjiptiane mbanin një vend me rotacion në kryesinë e Kuvendit. Serbët e Kosovës nga disa parti politike i fituan të 10 vendet e vëna mënjanë në Kuvend në zgjedhjet e nëntorit 2007. Para atyre zgjedhjeve, mbajtësit e atyre vendeve nuk i kërkuan postet e tyre të vëna mënjanë në kabinet dhe vazhduan t'i bojkotonin votimet e Kuvendit, ndonëse merrnin pjesë në komisione. Një serb i Kosovës udhëhoqi Ministrinë për Kthime. Kushtetuta kërkon që Kuvendi t'i rezervojë 10 vende për serbët e Kosovës dhe 10 për anëtarët e grupeve të tjera etnike, por pakicat etnike ishin të nënpërfaqësuara në nivelin komunal, ku nuk kishte kuota të ngjashme.

Sistemi i përgjithshëm zgjedhor nuk ndërroi shumë në krahasim me sistemin në fuqi gjatë mandatit së UNMIK-ut. Më 5 qershor, Kuvendi miratoi një ligj mbi zgjedhjet, të cilin Presidenti e nënshkroi më 15 qershor. Ligji i ri parashikon që vendi është zonë e vetme zgjedhore, shumanëtarëshe; zgjedhjet do të mbahen me lista të hapura sipas një sistemi proporcional-shumicë; një sistem i kuotës siguron përfaqësim adekuat për femra dhe pakica në kuvend; dhe partitë duhet ta kalojnë pragun prej 5 për qind për të hyrë në Kuvend.

Më 11 maj, serbët e Kosovës mbajtën zgjedhjet në enklava dhe në komunat e Kosovës me shumicë serbe për t'i themeluar qeveritë paralele komunale, dhe filluan t'i themelojnë këto organe paralele në qershor. Më 9 prill, UNMIK-u theksoi që organizimi i zgjedhjeve për këto struktura paralele ishte shkelje e Rezolutës 1244 të KSKB-së. Më 14 maj, UNMIK-u deklaroi se strukturat paralele komunale që dolën nga këto zgjedhje ishin të paligjshme dhe se nuk do të bashkëpunonte me to. Qeveria gjithashtu deklaroi që institucionet paralele ishin ilegale dhe të pavlefshme.

Korrupsioni dhe transparenca qeveritare

Ligji parashikon dënime penale për korrupsion zyrtar; megjithatë, qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efikase, dhe zyrtarët nganjëherë merreshin me praktika të korrupsionit pa u ndëshkuar.

Pati perceptim të gjerë publik për korrupsion në qeveri dhe UNMIK. Organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të vazhduan të raportonin që korrupsioni ishte problem serioz. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuuan korrupsionit në qeveri. Përkundër mandatit të vet në rënie e sipër, UNMIK-u vazhdoi t'i gjykonte shumë raste të ndjeshme që kishin të bënin me korrupsion dhe krime ndëretnike.

Në raportin e vet të nëntorit, Komisioni i Bashkësive Evropiane vuri në pah se korrupsioni ishte i përhapur dhe mbeti problem serioz në vend. Raporti pohoi se korniza ekzistuese legjislative institucionale që i adresohej korrupsionit ishte e paqartë dhe rekomandoi miratimin e më tepër ligjeve kundër korrupsionit, dhe zbatimin e tyre efikas. Komisioni gjithashtu vuri në pah se sistemi i dobët gjyqësor e pengonte përparimin në luftimin e korrupsionit.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, një organ i pavarur mbikëqyrës, kontrolloi menaxhimin dhe përgjegjësinë financiare të qeverisë qendrore, organeve komunale dhe ndërmarrjeve publike. Gjatë këtij viti, zyra auditoi secilën ministri, zyrën e Presidentit, dhe Kuvendin. Shumica e raporteve kritikonin menaxhimin administrativ dhe fiskal të qeverisë, dhe praktikat e prokurimit.

Qeveria ndërmori hapa për ta luftuar korrupsionin. Që nga 26 marsi, ligji kërkonte që zyrtarët qeveritarë t'i paraqitnin të gjitha dhuratat që i merrnin. Më 11 mars, Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit (AKK) njoftoi se kishte pranuar 61 raporte për korrupsion më 2007, dhe se korrupsioni më 2007 vlerësohej t'i kishte kushtuar qeverisë 31 milionë euro (rreth $40 milionë). Më 17 korrik, AKK vlerësoi se korrupsioni i kishte kushtuar qeverisë 6 milionë euro (rreth $7.8 milionë) gjatë gjysmës së parë të vitit.

Më 8 janar, *KosovaLive* raportoi se auditorët e brendshëm të ministrive, komunave dhe agjencive të Kosovës kërkonin që institucionet e Kosovës ta zbatonin ligjin e vitit 2006 mbi auditimin e brendshëm. Adem Zogiani, shef i Zyrës për Auditim pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, tha se Zyra për Auditim pengohej ta zbatonte ligjin që nga qershori 2007.

Më 3 qershor, prokuroria e Pejës njoftoi për ngritjen e akuzës kundër gjashtë ish-zyrtarëve ndërkombëtarë të UNMIK-ut dhe një vendësi nën dyshimin se kishin keqpërdorur 230,000 euro ($300,000) të dedikuara për projekte humanitare.

Më 26 qershor, pas një hetimi katër-mujor, policia arrestoi gjykatësin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Elez Hoxha, nën dyshimin për ryshfet. Në fund të vitit, Hoxha mbeti në arrest shtëpie, në pritje të procedurave të tjera gjyqësore.

Më 7 gusht, Ministria për Bashkësi dhe Kthime suspendoi për kohë të pacaktuar Emilija Rexhepin nga posti i drejtores së Departamentit të Administratës për shkak të konfliktit të interesit. Duke përdorur emër tjetër, Rexhepi gjoja kishte siguruar që një tender i ministrisë në vlerë prej rreth 90,000 eurove ($117,000) t'i jepej OJQ-së Barazia, të cilën e drejtonte më parë. Policia nuk i hapi hetimet deri në fund të vitit.

Hetimet e prokurorisë së Pejës lidhur me sjelljen e 11 nëpunësve ndërkombëtarë dhe 8 nëpunësve vendës të Hidro-Sistemit Radoniqi lidhur me marrëveshjet e tij me KEK-un vazhdoi gjatë këtij viti. Më 15 gusht, Gjykata e Qarkut në Pejë lejoi vazhdimin e hetimeve edhe për gjashtë muaj.

Më 22 janar, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e shpalli fajtore Sanije Gashin për përvetësim të 43,387 eurove ($59,233) në cilësinë e saj si menaxhere për buxhet dhe financa pranë Administratës Tatimore të Prishtinës. Më 23 maj, Gjykata Supreme e shqyrtoi ankesën e Gashit dhe më 23 qershor ia uli dënimin prej 4 në 2.5 vjet. Gjykata gjithashtu ia ndaloi Gashit të punonte në qeveri tri vjet pas lirimit të saj, dhe i urdhëroi t'i paguante shpenzimet e procedurës penale dhe t'ia kthente 43,387 eurot ($59,233) Administratës Tatimore të Kosovës.

Nuk pati zhvillime të mëtejshme në hetimin e sulmit të vitit 2006 kundër auditorit të përgjithshëm të pavarur ndërkombëtar, që ndodhi pasi zyra e tij kishte lëshuar një raport kritik për komunën e Prishtinës.

Auditimi i vitit 2006, i urdhëruar nga kryetari i Kuvendit, Kolë Berisha, për hetimin e mandatit të paraardhësit të tij, Nexhat Daci, zbuloi keqadministrim serioz, keqpërdorim të fondeve publike, dhe parregullsi në prokurim. Në dhjetor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e ngarkoi Dacin me tri akuza për përvetësim. Më 21 mars, një gjykatës ndërkombëtar konfirmoi aktakuzën, dhe Daci priste gjykimin në fund të vitit.

Pati zhvillime në rastin e Ahmet Alishanit, këshilltar i lartë i Dacit, i arrestuar më 2006 nën dyshimin për mashtrim dhe ryshfet. Më 21 mars, Alishani u akuzua për mashtrim dhe ryshfet, dhe nuk e pranoi fajin. Ai u lirua deri në fillim të gjykimit, i cili nuk filloi deri në fund të vitit.

Më 14 prill, gjykimi i Leme Xhemës, ish-drejtore e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (PTK); i Roger Reynolds-it, ish-menaxher i divizionit në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit; i Mustafa Nezirit, ish-drejtor i Norway Invest-it; i Ronnen Sorensen-it, ish-drejtor menaxhues e kryetar i Norway Invest-it; dhe i Ove Johansen-it, filloi në Prishtinë para gjykatësve ndërkombëtarë. Të pandehurit u akuzuan lidhur me keqpërdorimin e supozuar të 300,000 eurove ($390,000). Johansen, që u arrestua më 5 prill në Mal të Zi, thuhej ta kishte rregulluar transferimin mashtrues të këtyre mjeteve nga PTK-ja tek një kompani fantazmë me seli në Norvegji.

Pati zhvillime në rastin e Sabajdin Llonqarit dhe Fitim Maksutaj, dy ish-zyrtarë financiarë të burgut të Dubravës, që u arrestuan më 2006 për keqpërdorim të postit zyrtar dhe falsifikim të dokumenteve. Më 19 gusht, Gjykata Supreme konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë që ua ndalonte të pandehurve të hynin apo t'i afroheshin Burgut të Dubravës, apo të kontaktonin me dëshmitarë të ndryshëm dhe nëpunës të zyrës për financa të burgut deri më 29 gusht.

Ligji parashikon qasje në dokumentet zyrtare të qeverisë, por nuk përfshin dënimet për dështim të zbatimit të tij; në praktikë, ministritë rrallë ofronin qasje gjatë këtij viti. Nuk ka ligj që parashikon qasje publike në dokumentet zyrtare të UNMIK-ut dhe, në praktikë, publiku nuk ishte në gjendje të kishte qasje në këto dokumente.

Gjatë këtij viti, mediat rregullisht ankoheshin për mungesën e qasjes në dokumente zyrtare. Gazetarët gjithashtu e kritikuan afatin 15 ditësh, i cili do të thoshte që ata kurrë nuk do të mund t'i merrnin dokumentet zyrtare me kohë për ta përmbushur afatin e tyre për botim. Më 14 maj, OJQ-ja IREX raportoi se gjatë këtij viti vetëm 14.7 për qind e kërkesave të gazetarëve për informata ishin respektuar, që ishte më pak se vitin e kaluar, kur u respektuan 24.5 për qind të kërkesave. IREX raportoi se shumica e institucioneve ose nuk i kuptonin obligimet e veta ligjore, ose thjesht i injoronin ato.

Në gusht 2007, Shoqata e gazetarëve profesionistë të Kosovës raportoi se një studim që vlerësonte përgjigjen e institucioneve qeveritare dhe publike ndaj kërkesave të mediave për dokumente zyrtare tregoi se vetëm 23 për qind e kërkesave ishin kompletuar me sukses. Studimi tregoi se asnjë institucion të cilit gazetarët iu drejtuan nuk i siguroi kërkuesit regjistrin e dokumenteve në dispozicion.

Seksioni 4 Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut

Një numër i madh i grupeve vendëse dhe ndërkombëtare për të drejta të njeriut në përgjithësi punoi pa kufizim, duke hetuar dhe botuar konkluzionet e veta mbi rastet e të drejtave të njeriut. Qeveria, UNMIK-u, dhe KFOR-i në përgjithësi bashkëpunonin dhe u përgjigjeshin pikëpamjeve të tyre.

Më 29 mars, sulmues të panjohur hodhën një koktej Molotovi jashtë selisë së organizatës humanitare "Norewgian Church Aid" (Ndihma e kishës norvegjeze) në Mitrovicë, duke shkaktuar dëme të vogla. Hetimet e policisë vazhduan deri n fund të vitit.

Ombudspersoni ishte përgjegjës për hetimin e pohimeve për abuzim të ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga ana e Qeverisë. Ish-zëvendësi i ombudspersonit, Hilmi Jashari, vazhdoi të shërbente si ushtrues detyre i ombudspersonit gjatë këtij viti. Ndonëse ombudspersoni aktivisht lëshonte letra ndërhyrjeje, raporte dhe rekomandime, ato nuk zbatoheshin gjithmonë nga qeveria, gjykatat lokale apo SHPK-ja. Ombusdpersoni hetonte rastet që kishin të bënin me të drejta pronësore, me abuzim të autoritetit zyrtar, me akte administrative apo neglizhencë të autoriteteve publike, me mungesë të hetimeve të mirëfillta për vepra penale, me çështje ku përfshihej kohëzgjatja e procedurave gjyqësore dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, me konteste lidhur me punësimin, dhe me mosndëshkim. Në shtator, OSBE-ja vuri në pah se ndonëse secila ministri kishte themeluar njësinë për të drejta të njeriut, përafërsisht gjysma e tyre kishin mungesë të stafit të kualifikuar dhe nuk kishin buxhet të mjaftueshëm.

Më 2006, mandati i ombudspersonit u ndryshua për ta përjashtuar UNMIK-un nga fushëveprimi i vet; një panel i ri konsultativ për të drejta të njeriut në kuadër të UNMIK-ut u themelua në prill 2007 dhe u ngarkua për ta mbikëqyrur UNMIK-un. Në fund të vitit, Kuvendi ende nuk e kishte emëruar ombusdpersonin e ri, dhe ushtruesi i detyrës mbeti në detyrë.

Më 21 korrik, ombusdpersoni raportoi se gjykatat dhe ministritë ishin shkelësit më të shpeshtë të të drejtave të njeriut në vend. Ombusdpersoni gjithashtu vuri në pah, se reformat e fundit në gjyqësi nuk ishin të mjaftueshme, dhe se sistemi ende vuante nga të meta serioze.

Qeveria, UNMIK-u, dhe KFOR-i në përgjithësi bashkëpunuan me TPNJ-në. Më 4 prill, TPNJ liroi ish-kryeministrin Ramush Haradinaj dhe të bashkëpandehurin Idriz Balaj nga të gjitha akuzat që buronin nga vrasja e supozuar, persekutimi, dhunimi dhe torturimi i civilëve serbë të Kosovës më 1998. Gjykata shpalli fajtor të bashkëpandehurin Lahi Brahimajn për torturë dhe keqtrajtim të të burgosurve dhe e dënoi me 6 vjet burg.

Më 28 prill, TPNJ filloi gjykimin kundër Astrit Haraqisë, ish-ministër i Rinisë, Kulturës dhe Sporteve; dhe Bajrush Morinës, këshilltar i tij politik. Këta dy akuzoheshin se e kishin kërcënuar një dëshmitar që planifikonte të dëshmonte kundër Haradinajt. Më 17 dhjetor, TPNJ dënoi Haraqinë me pesë muaj burg, kurse Morinën me tre muaj.

Më 24 korrik, TPNJ shpalli fajtor gazetarin Baton Haxhiu për mospërfillje të gjykatës dhe publikim të emrave të dëshmitarëve të mbrojtur gjatë gjykimit të Haradinajt. Gjykata e dënoi Haxhiun me 7,000 euro ($9,100).

Seksioni 5 Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave

Ligji posaçërisht ndalon diskriminimin në bazë të racës, gjinisë, prejardhjes etnike, aftësisë së kufizuar, apo gjuhës; megjithatë, dhuna dhe diskriminimi i femrave, i personave me aftësi të kufizuara, dhe i pakicave etnike vazhdoi.

Femrat

Ligji e konsideron dhunimin vepër penale; megjithatë, dhunimi bashkëshortor nuk u trajtua në mënyrë të posaçme. Sipas kodit penal, dhunimi dënohet prej 1 – 10 vjet burg; dhunimi i të miturës (marrëdhënia seksuale me një vajzë nën moshën 14-vjeçare) dënohet prej 1 – 15 vjet burg.

Nuk u raportua në masë të madhe për dhunim për shkak të turpit kulturor që u bashkëngjitej viktimave dhe familjeve të tyre. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, avokatët e viktimave u ofruan shërbime viktimave në rreth 34 raste të dhunimit prej janarit deri në shtator. Policia e UNMIK-ut raportoi se, gjatë të njëjtës periudhë, 35 persona ishin arrestuar për dhunim dhe pesë ishin dënuar.

Dhuna në familje ndaj femrave, përfshirë këtu abuzimin bashkëshortor, mbeti problem serioz dhe i vazhdueshëm. Ligji ndalon dhunën në familje dhe parasheh dënime me burg prej 6 muaj deri në 5 vjet. Kur viktimat ngrinin padi, njësitë e SHPK-së për dhunë në familje kryenin hetime dhe ua kalonin rastet prokurorëve. Sipas UNMIK-ut, besnikëritë familjare dhe bashkësitë e lidhura ngushtë, dhe grumbullimi i rasteve në gjykatat civile dhe penale i shtuan shkallës së ulët të ndjekjes penale.

Si me dhunimin, dhuna në familje mbeti problem i madh për të cilin nuk u raportua aq shumë. Në korrik 2007, OSBE-ja lëshoi një raport mbi dhunën në familje që nxirrte në pah problemet në gjykimin e rasteve të dhunës në familje, përfshirë këtu vonesat e paligjshme në shqyrtimin e kërkesave për urdhra për mbrojtje. OSBE-ja gjithashtu shprehu shqetësim lidhur me procedurat e apelimit në rastet e dhunës në familje; në disa raste, gjykatat në mënyrë të paligjshme shënonin në vendimet e tyre se ankesa nga i pandehuri e pezullonte ekzekutimin e urdhrit për mbrojtje.

SHPK-ja raportoi se 21 viktima të dhunës në familje ishin vendosur në strehimore ndërmjet 1 janarit dhe 30 qershorit. Qendra për mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve u ofroi ndihmë 63 viktimave të dhunës në familje dhe të dhunës seksuale ndërmjet janarit dhe 24 shtatorit. Njësia e Ministrisë së Drejtësisë për përkrahje dhe ndihmë për viktima u angazhua në 646 raste të dhunës në familje ndërmjet janarit dhe qershorit. Dënimet në raste të tilla ishin të rralla dhe silleshin prej qortimeve gjyqësore deri në dënim me burg. Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj femrave në shoqërinë e dominuar nga meshkujt i kontribuuan shkallës së lartë të abuzimit në familje dhe numrit të vogël të rasteve të raportuara.

Nuk kishte agjenci qeveritare që merreshin enkas me dhunën në familje. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale u siguroi përkrahje financiare OJQ-ve që drejtonin strehimore për viktima të dhunës në familje, ku ishin të vendosura edhe disa viktima të trafikimit. Ministria siguroi shërbime sociale përmes Qendrave për Mirëqenie Sociale. Disa OJQ vendëse e ndërkombëtare zhvilluan aktivitete për t'u ndihmuar femrave; megjithatë, ato ishin të kufizuara nga tradita e heshtjes lidhur me dhunën në familje, abuzimin seksual dhe dhunimin.

Gjatë këtij viti, një linjë e drejtpërdrejtë anonime telefonike për raportimin e abuzimit në familje punonte 24-orë në ditë në Prishtinë, Gjilan, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë. Kjo linjë u

ofroi ndihmë 582 viktimave gjatë këtij viti; ajo pranoi 446 thirrje për dhunë në familje, 27 për raste të trafikimit, 25 për keqtrajtim të fëmijëve, dhe 35 për keqtrajtim seksual. Linja i informonte thirrësit për të drejtat e tyre, strehimet në dispozicion dhe informata përkatëse.

Shkolla për trajnimin e SHPK-së ofronte kurse speciale mbi dhunën në familje dhe dhunimin. Nuk pati raportime që SHPK-ja reagoi pa vend ndaj supozimeve për dhunim apo abuzim në familje.

Ndonëse ligji ndalon prostitucionin, ai mbeti i përhapur. Gjatë këtij viti, Njësia hetuese e Policisë së UNMIK-ut për trafikim dhe prostitucion ia kaloi përgjegjësitë e veta SHPK-së. UNMIK-u vazhdoi ta monitoronte dhe mentoronte SHPK-në.

Nuk ka ligj të posaçëm kundër ngacmimit seksual, që ishte problem i rëndomtë. Organizatat për të drejta të gruas treguan se ngacmimi seksual zakonisht ndodhte në vend të punës, por kalonte i paraportuar për shkak të frikës nga përjashtimi apo hakmarrja fizike. Vetëdijesimi publik për ngacmim seksual mbeti i ulët, dhe pak raste u raportuan.

Femrat kanë të drejta të njëjta ligjore si meshkujt, por tradicionalisht kanë status më të ulët shoqëror, gjë që ndikoi në trajtimin e tyre brenda sistemit ligjor. Me gjithë mungesën e pengesave ligjore, relativisht pak femra fituan pozita udhëheqëse të nivelit të lartë në tregti, SHPK, apo Qeveri. Ndonëse numri i femrave të punësuara vazhdoi të rritej, shkalla e papunësisë së femrave mbeti e lartë, rreth 80 për qind, 25 – 30 për qind më e lartë se shkalla e papunësisë për meshkuj. Femrat përbënin më pak se 30 për qind të fuqisë punëtore të qeverisë.

Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj femrave rezultuan në diskriminim. Në disa zona rurale, femrat shpesh kishin pak mundësi për të marrë vendime ku përfshiheshin fëmijët e tyre ose për të ushtruar kontroll mbi pronën. Ndonëse ligji nuk bën dallim në gjini lidhur me të drejtën për ta trashëguar pronën, prona e familjes zakonisht u kalohet vetëm meshkujve. Të vejat shqiptare, posaçërisht në zonat rurale, rrezikonin ta humbnin kujdestarinë e fëmijëve të vet për shkak të një zakoni i cili kërkonte që fëmijët dhe prona t'i kalohen familjes së babait të vdekur, ndërsa e veja të kthehet në familjen e saj.

Fëmijët

Ndonëse shkollimi është falas dhe i obligueshëm deri në moshën 15-vjeçare, sipas statistikave të vitit 2005, viti më i fundit për të cilat të dhënat ishin në dispozicion, treguan se vetëm 77 për qind e fëmijëve të moshës ndërmjet 7 dhe 14-vjeçare nga bashkësitë pakicë jo-serbe (romë, ashkalinj, egjiptianë, turq, boshnjakë, goranë dhe të tjerë) vijonin shkollimin. 69 për qind e vajzave nga pakicat jo-serbe e vijonin shkollimin. Për dallim nga kjo, 97.5 për qind e fëmijëve shqiptarë dhe 99 për qind e fëmijëve serbë ishin të regjistruar në shkollën fillore. Gjatë këtij viti, qeveria për herë të parë bleu libra falas për nxënës deri në klasën e pestë. Më pak se 10 për qind e fëmijëve të moshës dy deri në pesë vjeç e vijonin arsimin parashkollor.

UNICEF-i raportoi që mungesa e objekteve për shkollimin e pakicave në disa pjesë të Kosovës e vështirësoi kthimin e disa PZHBV-ve në shtëpitë e veta.

UNICEF-i vlerësoi që më pak se 75 për qind e fëmijëve që e mbaronin shkollimin e obligueshëm fillor, regjistroheshin në shkollën e mesme, dhe më pak se 55 për qind e vajzave

shqiptare regjistroheshin në shkollën e mesme. Vetëm rreth 40 për qind e vajzave nga bashkësitë pakicë jo-serbe regjistroheshin në shkollën e mesme.

Ligji kërkon kushte të barabarta për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga gjuha amtare, dhe parashikon të drejtën për shkollim publik në gjuhën amtare për nxënës të pakicave, deri në mbarim të shkollës së mesme. Shkollat që mësimin e zhvillonin në gjuhën serbe, boshnjake dhe turke punuan gjatë këtij viti. Fëmijët serbë dhe shqiptarë e vijonin mësimin në shkolla me lehtësira joadekuate të cilave u mungonin pajisjet themelore. Nxënësit serbë dhe shqiptarë i ndiqnin mësimet në disa shkolla të njëjta, por me programe të ndryshme mësimore dhe në ndërrime.

Fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë i vijonin mësimet në shkolla të përziera me fëmijët shqiptarë, por thuhej se përballeshin me kërcënim dhe ngacmim në disa zona me shumicë shqiptare. Fëmijët romë ishin më të prapambetur për shkak të varfërisë, gjë që i shtyri shumë prej tyre të fillonin të punonin në shtëpi e në rrugë që në moshë të re për të kontribuar në të ardhurat e familjes. Fëmijët romë ishin gjithashtu më të prapambetur sepse u desh ta mësonin një gjuhë tjetër për ta vijuar shkollimin pasi shumica flisnin gjuhën rome në shtëpi. Disa fëmijë boshnjakë në zonat kryesisht boshnjake e vijonin mësimin në gjuhën e tyre në shkollën fillore, por fëmijët që ishin jashtë zonave të tilla mësimin e vijonin në gjuhën shqipe.

Një studim i vitit 2006, i kryer nga UNICEF-i dhe Ministria e Arsimit lidhur me mbizotërimin e dhunës në shkolla, zbuloi se dhuna kundër fëmijëve kalonte pa u ndëshkuar. Ndëshkimi trupor ishte praktikë e pranuar në shtëpi dhe shkolla. Fëmijët që jetonin larg nga shkolla raportonin se kishin frikë ta kalonin atë distancë për shkak të kërcënimit të shokëve me dhunë. Fëmijët raportonin se personat afër tyre ishin autorë të veprave të dhunës; se djemtë ishin më të rrezikuar nga dhuna fizike, dhe se vajzat ishin më të rrezikuara nga abuzimi verbal.

Trafikimi i fëmijëve ishte problem. Më 7 gusht, misioni i OSBE-së në Kosovë dhe OJQ-ja ndërkombëtare "Terre des Hommes" filluan një fushatë të informimit publik kundër trafikimit të fëmijëve dhe kërkimit të lëmoshës nga fëmijët.

Si përgjigje ndaj këtij raporti, qeveria krijoi projektin "për shkolla të sigurta dhe pa dhunë", që përfshinte krijimin e një rrjeti mbarëkombëtar për parandalimin e dhunës. Aktivitetet përfshinin hartimin e një plani mbarëkombëtar për veprim për të siguruar mjedis të sigurt, pa dhunë e miqësor në shoqëri e shkolla, dhe aktivitete e seminare të ndryshme për ngritjen e vetëdijesimit. Më 11 shkurt, Ministria e Arsimit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale formuan një komision që kishte për qëllim parandalimin e dhunës në shkolla.

Fëmijët pa prind vendoseshin në vendbanime të ndryshme, përfshirë këtu kujdesin e zgjeruar familjar, kujdesin birësues, dhe në shtëpi të bashkësisë. Megjithatë, pasi programet vendore për adoptim dhe programet familjare për birësim nuk shkonin në hap me shkallën e braktisjes, autoritetet nganjëherë i vendosnin foshnjat dhe fëmijët në shtëpi grupore me pak kujdestarë. Fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh fshiheshin pa kujdes të duhur, posaçërisht në zonat rurale. Më 5 mars, Ministria e Arsimit filloi një fushatë tre-mujore për ngritjen e vetëdijesimit publik për fëmijët e moshës shkollore me aftësi të kufizuara dhe për përcaktimin e mënyrave për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.

Gjatë këtij viti, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale drejtoi 32 qendra për mirëqenie sociale që u ndihmuan 1,486 jetimëve dhe 1,585 fëmijëve delinkuentë. Ministria gjithashtu

menaxhoi jetimoret dhe koordinoi punën me OJQ për t'i vendosur fëmijët në strehimore të përkohshme. Sipas Ministrisë, gjatë këtij viti, 79 fëmijë jetonin në jetimore dhe shtëpi të financuara nga qeveria nën kujdes 24-orësh. Shtatë fëmijë të tjerë jetonin në Qendrën Klinike dhe Universitare të Prishtinës.

19 fëmijë të braktisur, me aftësi të kufizuara, të moshës prej 3 – 18-vjeç, jetonin në dy shtëpi të financuara nga qeveria nën kujdes 24-orësh.

Pati dëshmi anekdotike për martesë të fëmijëve, posaçërisht ndër bashkësitë rome, ashkalike, egjiptiane dhe shqiptare. Qeveria dhe OJQ-të nuk mblodhën të dhëna për këtë çështje, kështu që përmasa e këtij problemi ishte e paqartë.

Trafikimi i personave

Kushtetuta dhe ligji i ndalojnë të gjitha format e trafikimit të personave; megjithatë, pati raportime se personat trafikoheshin për në Kosovë, nga Kosova, përmes Kosovës dhe brenda saj. Trafikimi i femrave dhe i fëmijëve mbeti problem serioz, ndonëse mungesa e statistikave e vështirësoi llogaritjen e përmasës së trafikimit të fëmijëve.

Kosova ishte burim, pikë transiti dhe destinacion për persona të trafikuar, dhe trafikimi i brendshëm ishte problem në rritje e sipër. Viktimat ishin femra dhe fëmijë të trafikuar brenda vendit apo nga Evropa lindore dhe vende të tjera të Ballkanit për në Kosovë, kryesisht për shfrytëzim seksual, por edhe për robëri shtëpiake apo punë të detyruar në bare e restorante. Viktimat gjithashtu trafikoheshin përmes Kosovës për në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi dhe vende të Evropës perëndimore.

Sipas SHPK-së dhe IOM-it, trafikimi i personave ishte problem në rritje e sipër. Ndonëse shifrat e IOM-it dhe të SHPK-së dallonin nga pak, shënimet e këtyre dy organizatave tregonin se afërsisht 60 për qind e viktimave të trafikimit trafikoheshin brenda vendit, pasonin viktimat nga Moldavia (rreth 20 për qind), Shqipëria (10 për qind), dhe Bullgaria e Serbia (me nga 5 për qind). Numri i përgjithshëm i rasteve të trafikimit gjatë këtij viti sillej prej 20 – 27.

Prej viktimave të huaja që IOM-i u kishte ndihmuar që nga viti 1999, mbi 50 për qind ishin nga Moldavia, 19 për qind nga Rumania, 13 për qind nga Ukraina, dhe të tjerat ishin nga Bullgaria, Shqipëria, Rusia, Serbia, Mali i Zi, Sllovakia dhe Nigeria. Shumica e këtyre viktimave ishin të moshës ndërmjet 18 dhe 25-vjeçare. Shifrat e IOM-it tregonin se 82 për qind e viktimave kosovare trafikoheshin brenda vendit, ndërsa rreth 7 për qind trafikoheshin për në Maqedoni, 3 për qind për në Shqipëri, 3 për qind për në Itali, dhe më pak se 1 për qind për në Mbretëri të Bashkuar, Zvicër, Gjermani, Belgjikë, dhe Mal të Zi.

Numri i përgjithshëm i rasteve të trafikimit ku përfshiheshin të miturat shënoi rënie nga viti 2007. Gjatë këtij viti, IOM-i i ndihmoi një viktime të huaj të mitur, dhe pesë viktimave të mitura të trafikuara brenda vendit. SHPK-ja raportoi se katër viktima të trafikuara ishin të mitura, të gjitha nga Kosova. Fëmijët dhe vajzat e reja nga familjet me shkallë të lartë të varfërisë, papunësisë, abuzimit në familje, dhe analfabetizmit ishin posaçërisht në rrezik për t'u trafikuar. IOM-i raportoi se 10 për qind e viktimave vendëse nuk ishin të regjistruara në shkollë; 34 për qind e kishin mbaruar vetëm klasën e pestë të shkollës fillore; 44 për qind e kishin mbaruar klasën e nëntë të shkollës fillore; 11 për qind e kishin mbaruar shkollën e mesme; dhe më pak se 1 për qind i ndiqnin studimet në universitet.

SHPK-ja raportoi për vështirësi të mëdha në identifikimin e viktimave të trafikimit për shkak të ngurrimit të tyre për t'u paraqitur në polici për ta raportuar krimin. Tabutë kulturore dhe kërcënimi nga diskriminimi shoqëror bënë që shumica e viktimave të trafikuara brenda vendit të heshtnin për përvojat e tyre. Një vështirësi tjetër e vazhdueshme ishte pamundësia e SHPK-së për të rekrutuar policë serbë të Kosovës për njësinë kundër trafikimit, gjë që e pengonte zhvillimin e operacioneve të fshehta në Kosovën veriore dhe në enklavat serbe në Kosovë.

Viktimat e trafikimit shfrytëzoheshin kryesisht në industri të seksit, më së shumti në shtëpi publike dhe klube të natës, por me të madhe edhe në banesa private dhe përmes shërbimeve të prostitucionit. Asnjëra prej tyre nuk raportoi se e dinte që do të punonte në industri të seksit kur i lëshonin shtëpitë e tyre. Viktimat e trafikimit raportuan se rregullisht u nënshtroheshin rrahjeve dhe dhunimit, u mohohej qasja në kujdes shëndetësor, dhe u konfiskoheshin dokumentet e udhëtimit e të identifikimit. Viktimat shpesh gjendeshin në kushte të mjera fizike e psikologjike.

UNMIK-u raportoi se trafikantët shpesh punonin me grupe serbe dhe shqiptare të krimit të organizuar, dhe disa femra trafikoheshin prej Serbisë ose përmes Serbisë për në Kosovë. SHPK-ja raportoi se shumica e femrave ishin trafikuar në vend përmes Aeroportit të Prishtinës. Pronarët e bareve dhe të shtëpive publike i blinin viktimat nga bandat e krimit të organizuar.

Metodat e trafikimit vazhduan të bëheshin më të sofistikuara. Si reagim ndaj një fushate agresive të autoriteteve lokale e ndërkombëtare për çrrënjosjen e trafikimit, trafikantët e transferuan tregtinë e seksit komercial prej bareve e klubeve publike në shtëpi private, ku ishte më vështirë të zbuloheshin këto operacione. Trafikantët me të madhe e përdornin stimulimin financiar për t'i inkurajuar viktimat që ta refuzonin ndihmën.

IOM-i raportoi se prej 589 viktimave kryesisht ndërkombëtare që u kishte ndihmuar që nga viti 1999, rreth 75 për qind u bënë viktima të trafikantëve pas pranimit të ofertës së rreme për punë jashtë vendit, 3.7 për qind pohuan se ishin kidnapuar, dhe 3.9 për qind pohuan se u ishte premtuar martesë. Në 83.5 për qind të rasteve, rekrutimi bëhej përmes kontakteve personale; rekrutuesi ishte i njohur i viktimës në 28.8 për qind të rasteve dhe shok apo mik i familjes në rreth 18 për qind të rasteve. SHPK-ja raportoi se rekrutuesit ishin meshkuj dhe femra. IOM-i dhe SHPK-ja raportuan se personat e trafikuar shpesh kishin kontrata pune që u mundësonin të hynin legalisht në vend dhe të fitonin leje qëndrimi. Kjo e vështirësonte zbulimin dhe vërtetimin e trafikimit të personave.

Sipas të drejtës penale, trafikimi është krim që dënohet deri në 20 vjet burg. Marrja me trafikim dënohet prej 2 deri në 12 vjet burg, ose deri në 18 vjet nëse viktima është e mitur; organizimi i një grupi për t'u marrë me trafikim dënohet prej 7 deri në 20 vjet burg dhe me gjobë deri në 500,000 euro ($650,000); lehtësimi i trafikimit nëpërmjet neglizhencës dënohet prej 6 muaj deri në 5 vjet burg. Klienti që fajësohet për marrëdhënie seksuale me një person për të cilën dihet se është viktimë e trafikimit mund të dënohet me burg prej tre muaj deri në 5 vjet, ndërsa marrëdhënia seksuale me një të mitur për të cilën dihet se është viktimë e trafikimit mund të dënohet prej 2 deri në 10 vjet burg. Lehtësimi i prostitucionit dënohet me gjobë apo me burg deri në tri vjet, dhe deri në pesë vjet nëse ndodh brenda perimetrit prej 350 metrash nga shkolla apo ndonjë lokacion tjetër që shfrytëzohet nga fëmijët. Kur kundërvajtja për prostitucion përfshin viktimat që janë të mitura, dënimi me burg mund të jetë deri në 12 vjet. Prostitucioni dënohet si kundërvajtje; prostitutat mund të dënohen, por jo edhe klientët, nëse policia nuk mund të dëshmojë që klienti me qëllim i ka shfrytëzuar shërbimet e viktimës

së trafikimit. Prostitucioni përbën bazë për dëbim, përveç nëse “prostituta” është viktimë e trafikimit.

Gjatë këtij viti, SHPK-ja mbajti përgjegjësinë kryesore për luftimin e trafikimit të personave dhe kreu 82 operacione të vëzhgimit. SHPK-ja gjithashtu mbylli një ndërmarrje afariste që përdorej për trafikim. SHPK-ja arrestoi 48 meshkuj dhe 19 femra për trafikim, 10 për kodoshllëk, 13 për prostitucion, dhe 8 për akuza të lidhura me trafikimin, si posedimi ilegal i armëve dhe falsifikimi. SHPK-ja gjithashtu identifikoi 27 viktima të trafikimit, 22 prej të cilave morën ndihmën e nevojshme, përfshirë këtu akomodimin e sigurt, këshillimin dhe trajnimin profesional për kthim dhe riintegrim në shoqëri. Pesë të tjerat e refuzuan këtë ndihmë, duke thënë se nuk ishin trafikuar. Së paku një strehimore ofronte kujdes shëndetësor në përputhje me marrëveshjet me ofruesit e kujdesit shëndetësor. Gjatë këtij viti, zyra e prokurorit ushtroi kallëzim penal për 27 raste të trafikimit; 50 raste të tjera nga viti i kaluar mbetën të hapura. 14 prej këtyre rasteve u përfunduan, 13 rezultuan me dënime. Në një rast, i pandehuri u lirua nga akuza.

Faktorët që i kontribuuan numrit të ulët të ndjekjeve penale përfshinin përsosjen gjithnjë e më të madhe të krimit të organizuar për t’iu shmangur lidhjeve të drejtpërdrejta ndërmjet viktimave dhe personaliteteve të larta të krimit, mungesën e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve (ndonëse përdoreshin mjete për të siguruar anonimitet gjatë dëshmisë në gjykim), ngurrimin e viktimave për të bashkëpunuar me autoritete, trajnimin joadekuat të personelit gjyqësor, dhe dështimin e policisë për t’iu përshtatur teknikave të reja që përdoreshin nga trafikantët

Rregulloret e UNMIK-ut parashikojnë mbrojtje për viktima të trafikimit ndaj kallëzimeve penale për prostitucion, hyrje ilegale, prani, apo punë në vend.

SHPK-ja ndau përgjegjësinë për luftimin e trafikimit me UNMIK-un, policinë kufitare, OSBE-në, Ministrinë e Punëve të Brendshme, prokurorët, gjykatësit, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare, posaçërisht IOM-i, merreshin me aktivitete për mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e trafikimit

Pati dëshmi anekdotike gjatë këtij viti se ekzistonte një grup i ndërlikuar i marrëdhënieve financiare dhe i lidhjeve familjare ndërmjet udhëheqësve politikë dhe rrjeteve të krimit të organizuar që kishin interesa financiare nga trafikimi.

Pati një sërë arrestimesh dhe policia ndërmori masa kundër trafikantëve gjatë këtij viti. Më 31 janar, p.sh., SHPK-ja, në bashkëpunim me zyrën e prokurorit special, kreu bastisje herët në mëngjes në gjashtë lokacione në Gjakovë, me ç’rast ndaloi 15 veta. Policia arrestoi pesë veta dhe katër femra i dërgoi në strehimore. Në seancën e parë gjyqësore, gjykatësi urdhëroi që dy trafikantë vendës dhe një moldaviane, që dukej të ishte e përfshirë në menaxhimin e femrave të tjera, të mbahen 30 ditë në paraburgim. Data e gjykimit ende nuk është caktuar. Në fund të vitit, meshkujt mbetën në burg, kurse femra ishte liruar pas gjashtë muajsh burg.

Më 14 prill, në Ferizaj, policia arrestoi një ashkali për trafikim të një vajze 14-vjeçare dhe kodoshllëk. Viktima u dërgua në strehimore dhe më pas u kthye në shtëpi. Policia e mbajti trafikantin deri më 14 korrik, dhe më pas e liroi dhe e vuri në arrest shtëpie. Policia arrestoi edhe një burrë tjetër në lidhje me rastin e 7 majit; data e gjykimit nuk ishte caktuar deri në fund të vitit.

Më 27 maj, Gjykata e Qarkut në Pejë i shpalli fajtorë Aleksandër Pitaqin, Pal Pitaqin, Veronika Dragajn, dhe Elena Pislarin, të gjithë anëtarë të rrjetit kriminel Pitaqi, për trafikim të personave, spastrim parash dhe lehtësim të prostitucionit. Gjykata konstatoi se trafikantët, meshkuj e femra, drejtonin një grup të organizuar kriminel që rekrutonte dhe mbante femra nga Moldavia për shfrytëzim seksual. Trafikantëve iu shqiptuan gjoba deri në 85,874 euro ($118,713) dhe dënime prej 5-6 vjet burg.

Nuk pati informata shtesë në dispozicion për arrestimin në janar 2007 të dy shqiptarëve të Kosovës që drejtonin kafenetë Suka dhe Suka 1 në Prizren.

Gjatë këtij viti, policia arrestoi personin e gjashtë dhe të fundit që kërkohej në lidhje me rrjetin e trafikimit që vepronte në një shtëpi private në Gjilan. SHPK-ja arrestoi pesë të dyshuarit e tjerë në mars 2007.

OJQ-të ndërkombëtare dhe vendëse, të financuara nga donatorë të huaj, ishin burimi kryesor i ndihmës për viktimat e trafikimit. OJQ-të vendëse, si Qendra për mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e trafikimit dhe Qendra për mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve, në bashkëpunim me UNMIK-un, OSBE-në dhe IOM-in, drejtonin strehimore ku viktimave të trafikimit u ofrohej kujdes mjekësor dhe shërbime të këshillimit psikologjik. OJQ-ja Shpresë dhe Shtëpi për Fëmijë drejtonte një strehimore për fëmijët që ishin viktima të trafikimit, dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me UNMIK-un dhe OSBE-në, drejtoi një njësi strehimi grupor, gjysmë të pavarur, për të miturit që ishin viktima të trafikimit dhe të dhunës në familje. Disa strehimore vendëse për viktima të dhunës në familje, si Liria në Gjilan, ofronin strehim afatshkurtër dhe shërbime referimi për viktima të rrezikut të sigurisë së ulët. Një objekt i përkohshëm i udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë u ofronte strehim të përkohshëm viktimave gjersa ato mendonin të riatdhesoheshin apo të dëshmonin kundër trafikantëve. Policia shpesh ia drejtonte IOM-it viktimat e dyshuara të trafikimit nëpërmjet zyrtarëve rajonalë të OSBE-së.

Raporti vjetor i Departamentit të Shtetit mbi Trafikimin e Personave mund të gjendet në këtë adresë: www.state.gov/g/tip.

Personat me aftësi të kufizuara

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në punësim, shkollim, qasje në kujdes shëndetësor, dhe në ofrim të shërbimeve të tjera shtetërore; megjithatë, gjendja e personave me aftësi të kufizuara mbeti e vështirë. Pati diskriminim të madh në praktikë, dhe sigurimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara nuk ishte prioritet i qeverisë.

Ndonëse ligji urdhëron qasjen në ndërtesa zyrtare, ai nuk u zbatua dhe qasja e tillë rrallë ishte në dispozicion në praktikë.

Sipas OJQ-së vendëse për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, HandiKos, ligjet ekzistuese lidhur me personat me aftësi të kufizuara nuk zbatoheshin në mënyrë adekuate. Si rrjedhojë, fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh përjashtoheshin nga mundësitë edukative, nuk vlerësoheshin në mënyrë profesionale, dhe u mungonin shërbime të mjaftueshme shëndetësore dhe sociale.

Sipas Ministrisë së Arsimit, në Kosovë ishin 14-15,000 fëmijë me aftësi të kufizuara. Ekzistonin gjashtë shkolla speciale për fëmijë me aftësi të kufizuara, dhe 70 klasë për fëmijë me nevoja të posaçme që u ishin shtuar shkollave të rregullta. Ministria raportoi se kishte mbi 877 nxënës që pranonin shkollim special.

Nuk pati mbrojtje të posaçme ligjore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në maj, Kuvendi miratoi "Ligjin për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme", që hyri në fuqi në qershor. Ky ligj parashikon përkufizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe u lejon kujdestarëve ligjorë të fëmijëve të tillë të konkurrojnë për përkrahje materiale në Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Megjithatë, ligji nuk u zbatua deri në fund të vitit.

Sipas OJQ-së Mental Disability Rights International (MDRI), pacientët me aftësi të kufizuara mentale vazhdonin të mbaheshin të izoluar pa kurrfarë baze ligjore, pasi nuk kishte ligj për ta rregulluar procesin e dërgimit të personave në objekte të kujdesit psikiatrik ose social, apo për t'i mbrojtur të drejtat e tyre brenda institucioneve. Herë pas here, individët që kishin nevojë për trajtim në shëndet mental dënoheshin për krime të inskenuara ose të vogla dhe dërgoheshin në burgje të cilave u mungonin burimet për trajtim adekuat. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), kishte rreth 14,000 persona me aftësi të kufizuar mentale; MDRI raportoi se rreth 50,000 persona me aftësi të kufizuar mentale jetonin jashtë institucioneve. Sipas MDRI-së, personat e tillë çonin jetë të izoluar dhe të stigmatizuar.

Këshilli Nacional për Persona me Aftësi të Kufizuara ekzistonte si organizatë këshillimore për organet e qeverisë dhe të Kuvendit. Ndonëse kryetari i këshillit theksoi se prioritet ishte hartimi i një platforme mbarëkombëtare për persona me aftësi të kufizuara, ajo nuk u hartua deri në fund të vitit.

Më 2006, MDRI raportoi se Instituti i Shtimes, i drejtuar nga qeveria, për të cilin MDRI-ja kishte raportuar më parë për abuzim dhe keqtrajtim të pacientëve, ishte ndarë në një objekt për persona me aftësi të kufizuara zhvillimore, me 74 pacientë, dhe në një objekt psikiatrik me 68 pacientë. Shumica e pacientëve në Shtime ishin serbë të Kosovës dhe pakica të tjera. Numri i përgjithshëm i pacientëve në këto objekte shënoi rënie, për shkak të brengave të MDRI-së për mbingarkim, por filloi të pranonte pacientë të rinj gjatë këtij viti. MDRI nxiti qeverinë ta përmirësonte mbështetjen e bashkësisë dhe ta shtonte vetëdijesimin publik për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara mentale.

Gjatë këtij viti, Ministria e Shëndetësisë drejtoi tetë shtëpi për integrim dhe korrektim anembanë vendit, secila kishte nga 10 pacientë mendërisht të sëmurë. Ministria gjithashtu drejtoi një qendër integrimi me 60 pacientë në Shtime. Megjithatë, MDRI raportoi se, ndonëse këto shtëpi ishin të menduara si të përkohshme, shumica e pacientëve kaluan vite të tëra në to me pak gjasa për t'u kthyer në bashkësi. Sipas një raporti të OBSH-së të vitit 2006, nuk kishte objekte të mjaftueshme për të siguruar kujdes për personat me aftësi të kufizuar mentale, dhe mundësitë për punësimin e tyre ishin të kufizuara.

Pakicat kombëtare/raciale/etnike

Diskriminimi zyrtar dhe shoqëror i bashkësisë serbe, rome, ashkalike dhe egjiptiane sa i përket punësimit, shërbimeve sociale, përdorimit të gjuhës, lirisë së lëvizjes, të drejtës për t'u kthyer, dhe të drejtave të tjera themelore vazhdoi. Anëtarët e bashkësisë boshnjake dhe gorane gjithashtu u ankuan për diskriminim. Gjatë këtij viti, dhuna dhe krimet e tjera të drejtuara

kundër pakicave dhe pronës së tyre u ngritën nga viti 2007. Punësimi i pakicave në institucione publike vazhdoi të ishte i ulët dhe në përgjithësi kufizohej në nivele më të ulëta të qeverisë; anëtarët e pakicave zinin 10.4 për qind të vendeve të punës në qeveri, përkundër synimit të qeverisë prej mbi 16 për qind.

Në korrik 2007, ombusdpersoni për të drejta të njeriut lëshoi një raport që konkludoi se diskriminimi etnik ishte problem i përhapur dhe i vazhdueshëm, posaçërisht në fushën e kujdesit shëndetësor dhe të punësimit. Raporti gjithashtu vuri në pah se grupet e pakicave vazhdonin të përballeshin me kërcënime të rregullta.

Ndërmjet 1 janarit dhe 31 gushtit, policia e UNMIK-ut raportoi 798 raste të krimit ndëretnik; serbët ishin të përfshirë si viktima apo të dyshuar në 617 raste. Sipas UNMIK-ut, nënraportimi i incidenteve ndëretnike vazhdoi si rrjedhojë e politikës së SHPK-së që u jepte prioritet të ulët atyre dhe për shkak të mosbesimit të vazhdueshëm ndërmjet pakicave dhe shumicës shqiptare të Kosovës.

Pati raportime të shumta për dhunë kundër serbëve të Kosovës gjatë këtij viti, që zakonisht hetohej nga Policia e UNMIK-ut. Më 23 prill, p.sh., në Gjilan, një shqiptar i Kosovës sulmoi një serb të Kosovës, i cili pësoi lëndime të lehta trupore.

Më 2 qershor, OSBE-ja raportoi se një serb i Kosovës u përpoq ta vizitonte pronën e vet në Deçan me anëtarët e një ekipi të UNDP-së, që planifikonin t'i ndihmonin ta rindërtonte shtëpinë e vet. Megjithatë, kur ai arriti në pronën e vet, një fqinj, shqiptar i Kosovës, që në mënyrë të paligjshme e shfrytëzonte pronën në mungesë të pronarit, e pengoi grupin që të hynte në pronë. Ndonëse kryetari i komunës u përpoq të ndërmjetësonte në këtë kontest, palët nuk arritën asnjë marrëveshje deri në fund të vitit.

Më 1 korrik, në Gjilan, tri shqiptare të paidentifikuara të Kosovës fizikisht sulmuan dhe lënduan një serbe të Kosovës. Policia nuk arrestoi askënd, dhe hetimet vazhduan deri në fund të vitit.

Më 17 korrik, në Istog, një shqiptar i paidentifikuar i Kosovës e grushtoi dhe shkelmoi serbin Zharko Oroviq, një i kthyer i mundshëm që kishte ardhur për vizitë nga Mali i Zi, dhe ia vodhi 350 euro ($450). Oroviq u hospitalizua dhe u lirua; hetimet e policisë vazhduan deri në fund të vitit.

Më 30 dhjetor, dy të rinj shqiptarë të Kosovës nga Mitrovica veriore e qëlluan me thikë një serb 16-vjeçar në Mitrovicën veriore gjatë një konfrontimi me të rinj serbë. Të dy shqiptarët ikën në anën jugore të qytetit, ku u arrestuan nga policia. Disa orë pas incidentit, dhuna ndëretnike shpërtheu në tri komunat shumetnike në Mitrovicën veriore. Kjo dhunë përfshiu të shtënat me armë automatike, sulmet fizike, vandalizmin e veturave, dhe zjarrvënien. Gjatë dhunës, një shqiptar i Kosovës u qëllua. Si përgjigje ndaj situatës, KFOR-i, policia e EULEX-it dhe SHPK-ja mbyllën urën mbi lumin Ibër, e cila ndan pjesën veriore dhe jugore të qytetit të ndarë. Pas nja dy orësh, gjendja iu kthye normales. Policia dhe prokurorët ishin duke hetuar incidentet nga fundi i vitit.

Nuk pati informata të tjera në dispozicion gjatë këtij viti lidhur me hetimet për rastin e goditjes me thikë në shkurt 2007 të një serbeje të Kosovës prapa një kafeneje në Mitrovicë, apo për aktakuzën e qershorit 2007 ndaj Sabri Hazirit, i cili akuzohej të kishte ndihmuar në vendosjen e një bombe në urën e hekurudhës afër fshatit Llozishtë në Zveçan.

Nuk pati informata të reja në dispozicion për këto raste të vitit 2006: goditja me thikë, në mars, e një serbi të ri të Kosovës nga dy të rinj shqiptarë afër urës kryesore në Mitrovicën veriore; dhe eksplodimi në dhjetor në linjën hekurudhore që shpesh përdorej nga anëtarët e pakicës serbe në komunën e Vushtrrisë.

Gjatë këtij viti, SHPK-ja raportoi se kishte arrestuar dhe burgosur personat që kishin shtënë me armë në shtëpitë e serbëve të kthyer në fshatin Llugë të Istogut më 2006. Të pandehurit u dënuan me dy deri në tre muaj burg.

Gjatë këtij viti pati raportime të rregullta që shqiptarët e Kosovës e shkatërronin pronën private që u takonte serbëve të Kosovës; disa raste të dhunës kundër serbëve mund të kenë qenë përpjekje për t'i detyruar që ta shitnin pronën e tyre. Një rregullore e UNMIK-u ndalon shitjen me shumicë të pronës së bashkësive të serbëve të Kosovë në përpjekje për ta penguar kërcënimin e pronarëve të pronave të pakicave në zona të caktuara; megjithatë, ajo rrallë zbatohej. Pati raportime të shumta që serbët e Kosovës kishin vështirësi për t'iu qasur pronës së tyre, që nganjëherë ishte e zënë ose shfrytëzohej nga shqiptarët e Kosovës. P.sh., më 16 qershor, në Vushtrri, një serb i Kosovës i raportoi SHPK-së se një shqiptar i Kosovës ia kishte zënë në mënyrë të paligjshme tokën bujqësore gjatë tetë vjetëve të kaluara dhe nuk mund të kishte qasje në të. Policia e solli të dyshuarin në stacion dhe e liroi pas një bisede.

Më 2 prill, në Klinë, një serb i Kosovës raportoi se prona e tij ishte uzurpuar nga një shqiptar i Kosovës. Nuk kishte informata të tjera në dispozicion lidhur me këtë rast.

Në disa raste u raportua që prona e serbëve të Kosovës shitej nga personat që rrejshëm pretendonin të ishin avokatë të tyre dhe paraqitnin dokumente të falsifikuara në gjykatë; në rastet në të cilat pronarët e ligjshëm nuk jetonin në Kosovë, mashtrimi i tillë nuk zbulohej me muaj të tërë.

Më 2006, komunat e Kosovës me shumicë serbe të Zveçanit, Mitrovicës, Zubin Potokut dhe Leposaviqit i ndërprenë marrëdhëniet e tyre me qeverinë. Pas zgjedhjeve lokale të 11 majit, autoritetet paralele të serbëve të Kosovës e vazhduan këtë politikë dhe nuk komunikuan me qeverinë gjatë këtij viti.

Pati një sërë përleshjesh ndërmjet grupeve të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës gjatë këtij viti. Më 26 qershor, p.sh., serbët e Kosovës mbajtën një protestë në fshatin Berivojcë, etnikisht të përzier, lidhur me ndërtimin e një xhamie. SHPK-ja raportoi se gjatë protestës, grupe të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës filluan të rrihen mes vete. Policia dhe KFOR-i ndërhynë kur pjesëmarrësit filluan të gjuanin gurë, dhe dy policë pësuan lëndime të lehta në kokë. Edhe disa protestues u lënduan.

Më 4 korrik, shqiptarë dhe serbë të Kosovës u përleshën në lagjet Tre Rrokaqiejt dhe Suhodoll pas protestave të serbëve të Kosovës kundër instalimit të gypave të ujit në një zonë të shqiptarëve të Kosovës afër Suhodollit. Disa pjesëmarrës dhe një polic serb i SHPK-së u lënduan. Katër shqiptarë të Kosovës u arrestuan në lidhje me këtë incident.

Më 7 korrik, në lagjen Tre Rrokaqiejt, një grup prej rreth 20 shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës filloi të gjuante gurë kundër njëri-tjetrit. Një serb i Kosovës u lëndua rënd. Më vonë gjatë ditës, rreth 15 serbë të Kosovës u tubuan dhe bllokuan rrugën ndërmjet Mitrovicës dhe Suhodollit. Policia intervenoi dhe shpërndau këtë grup.

Gjatë këtij viti, OSBE-ja raportoi se sistemi i judikaturës penale ende ballafaqohej me vështirësi në shqyrtimin e rasteve nga trazirat e marsit 2004. Raporti vuri në pah vështirësi të vazhdueshme në sigurimin e deklaratave të dëshmitarëve, në dështimin e gjerë për t'i dënuar autorët e supozuar të krimeve me dënime të përshtatshme penale, dhe vonesat e gjata në procedura. Në shumë raste, gjykatat nuk i konsideronin motivet etnike si faktor rëndues. Raporti konkludoi se nuk kishte pasur përparim të madh në shqyrtimin e këtyre rasteve që nga raporti i kaluar i OSBE-së, në dhjetor 2005, mbi këtë çështje.

Pati zhvillime të reja në rastet e disa personave të përfshirë në trazirat e vitit 2004. Në janar, Gjykata e Qarkut në Prishtinë i shpalli fajtorë Skender Islamin, Mustafa Islamin, Ramadan Islamin, Omer Sylejmanin, dhe Gazmend Morinën për djegie të spitalit, të shkollës dhe të disa shtëpive e veturave serbe. Gjykata i dënoi të pandehurit prej 2 deri në 7 vjet burg dhe u urdhëroi t'i paguanin gjithsej 73,000 euro ($95,000) dëmshpërblim.

Gjykimi i Zlyhaje Avdullahut, e akuzuar për pjesëmarrje në turmën e shqiptarëve të Kosovës që theu, plaçkiti dhe dogji shtëpitë e serbëve të Kosovës, dhe që sulmoi serbët e Kosovës gjatë trazirave të vitit 2004, pritej të mbahej nga fundi i vitit.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, nuk pati raportime për dhunë me motive etnike kundër anëtarëve të pakicave jo-serbe gjatë këtij viti.

Nuk pati zhvillime të reja në lidhje me incidentin e janarit 2007 në Pejë, në të cilin dy shqiptarë të Kosovës sulmuan dhe lënduan rënd një egjiptian të Kosovës, apo të sulmit në maj 2007 kundër një boshnjaku të Kosovës nga një shqiptar i Kosovës. Në rastin e dytë, viktima u hospitalizua me lëndime të rënda, dhe policia arrestoi një të dyshuar.

Nuk pati zhvillime të reja në rastet e vitit 2006 ku përfshiheshin sulmi kundër malaziasit të zhvendosur Vuko Danilloviq, nga një grup i shqiptarëve të Kosovës, dhe sulmi me bombë në shtëpinë e një gorani, përfaqësues i Qendrës koordinuese të Beogradit për Kosovë e Metohi.

Romët vuanin nga diskriminimi i përhapur shoqëror dhe ekonomik; shpesh u mungonte qasja në higjienë themelore, kujdes mjekësor, dhe shkollim; dhe vareshin me të madhe nga ndihmat humanitare për mbijetesë. Ndonëse pati disa përpjekje të suksesshme për rivendosjen e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në shtëpitë që i kishin para konfliktit të vitit 1999 në Vushtrri, brengat e sigurisë vazhduan.

Më 12 qershor, OSBE-ja raportoi se tri familje të kthyera rome nuk do të ngarkoheshin për ujë dhe shërbime që u ishin siguruar shtëpive të tyre në Kosovë gjersa familjet ishin të zhvendosura në Maqedoni prej vitit 1999 deri më 2007. Pas kthimit të tyre më 2007, kompania e shërbimeve publike në Gjilan kërkoi pagesën për shërbimet që u ishin ofruar shtëpive të familjeve, që ishin të uzurpuara gjatë kohës së zhvendosjes së tyre. UNHCR-ja ndërhyri dhe u ndihmoi familjeve në sigurimin e dokumenteve të nevojshme për ta dëshmuar zhvendosjen e tyre. Si rrjedhojë, kompania e shërbimeve publike u pajtua t'i hidhte poshtë kërkesat e veta kundër këtyre familjeve të kthyera.

Udhëheqësit boshnjakë u ankuan se mijëra anëtarë të bashkësisë së tyre ishin larguar nga vendi për shkak të diskriminimit dhe mungesës së mundësive ekonomike.

Abuzimet e tjera shoqërore dhe diskriminimi

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e bazuar në orientim seksual; megjithatë, pati raportime për dhunë dhe diskriminim të homoseksualëve dhe lezbikeve.

Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj homoseksualizmit i frikësonin shumicën e homoseksualëve dhe lezbikeve, kështu që ata e fshihnin orientimin e tyre seksual. Homoseksualët dhe lezbiket në përgjithësi ndjeheshin të pasigurt, shumë prej tyre raportonin kërcënime për sigurinë e tyre personale. Këtë vit pati më pak kërcënime të raportuara se viteve të mëparshme; megjithatë, kjo mund të ketë qenë si rrjedhojë e kujdesit më të madh të ndërmarrë nga homoseksualët dhe lezbiket në aktivitetet e tyre. Mediat e shkruara nganjëherë i forconin qëndrimet negative duke botuar artikuj për homoseksualizmin, në të cilët homoseksualët dhe lezbiket i përshkruanin si të sëmurë mentalë. Së paku një parti politike me orientim islam, Partia e Drejtësisë, përfshiu në platformën e vet politike dënimin e homoseksualizmit.

Nuk pati zhvillime të reja në rastin e majit 2007, në të cilin katër meshkuj, tre të veshur në fustane, ishin ngacmuar nga policët e SHPK-së. Qendra për Emancipim Social, një OJQ vendëse që i përkrah të drejtat e lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, dhe të transgjinive, theksoi se pati shumë raste të tjera të diskriminimit të homoseksualëve gjatë këtij viti, por viktimat refuzonin t'i lejonin që rastet e tyre t'i paraqitnin publikisht për shkak të frikës nga diskriminimi.

Nuk pati zhvillime të reja në rastin e sulmit më 2006, në të cilin persona të panjohur rrahën brutalisht dy meshkuj të cilët i panë duke bërë seks.

Pati raportime anekdotike për diskriminim të personave me HIV/AIDS gjatë këtij viti.

Seksioni 6 Të drejtat e punëtorëve

a. E drejta e asociimit

Rregulloret e UNMIK-ut u lejojnë punëtorëve të formojnë dhe t'u bashkëngjiten sindikatave të pavarura që ata i zgjedhin, pa autorizim paraprak ose kërkesa të tepërta, por kjo e drejtë pengohej nganjëherë nga ndërmarrjet të cilat i kërcënonin punëtorët e vet kur ata u bashkoheshin apo formonin sindikata. Rregulloret e UNMIK-ut nuk e njohin të drejtën për të bërë grevë; megjithatë, grevat në përgjithësi u lejuan në praktikë, dhe disa greva ndodhën gjatë këtij viti. Qeveria nuk miratoi ligjet mbi punën deri në fund të vitit, kështu që rregulloret e UNMIK-ut mbetën në fuqi.

Sindikatat e vetme të rëndësishme ishin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) dhe Konfederata e Sindikatave të Lira (KSL).

b. E drejta për t'u organizuar dhe negociuar kolektivisht

Ligji dhe rregulloret e UNMIK-ut gjithashtu parashikojnë të drejtën për t'u organizuar dhe negociuar kolektivisht pa ndërhyrje, dhe Qeveria nuk e kufizoi këtë të drejtë në praktikë; megjithatë, negociimi kolektiv nuk ndodhi gjatë këtij viti. Ligji dhe rregulloret e UNMIK-ut u lejojnë sindikatave t'i udhëheqin aktivitetet e veta pa ndërhyrje, dhe qeveria dhe UNMIK-u e mbronin këtë të drejtë në praktikë.

Rregulloret e UNMIK-ut ndalojnë diskriminimin antisindikal; megjithatë, disa zyrtarë të sindikatave raportuan për diskriminim në praktikë. BSPK-ja raportoi se vetëm një numër i vogël i ndërmarrjeve e respektonte rregulloren që ndalonte diskriminimin antisindikal dhe pohoi se të drejtat e punëtorëve abuzoheshin në çdo sektor, përfshirë këtu organizatat ndërkombëtare, ku personeli nuk kishte sigurim apo pension.

Nuk ka zona përpunuese për eksport.

c. Ndalimi i punës së dhunshme apo të detyruar

Ligji dhe rregulloret e UNMIK-ut ndalojnë punën e dhunshme apo të detyruar, përfshirë këtu punën e fëmijës; megjithatë, pati raportime se femrat dhe fëmijët trafikoheshin për shfrytëzim seksual, robëri shtëpiake dhe punë të detyruar në bare e restorante.

d. Ndalimi i punës së fëmijës dhe mosha minimale për punësim

Ligji dhe rregulloret e UNMIK-ut ndalojnë shfrytëzimin e fëmijëve në vend të punës, përfshirë këtu ndalimin e punës së dhunshme apo të detyruar; megjithatë, përveç trafikimit, qeveria dhe UNMIK-u rrallë i kundërshtonin këto praktika. Trafikimi i fëmijëve, kryesisht për shfrytëzim seksual komercial, ishte problem serioz, ndonëse mungesa e shënimeve statistikore e vështirësoi llogaritjen e përmasës së trafikimit të fëmijëve.

Rregulloret e UNMIK-ut e caktojnë moshën 16-vjeçare si moshë minimale për punësim dhe moshën 18-vjeçare si moshë minimale për cilëndo punë që mund ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve, por lejojnë që fëmijët të punojnë edhe në moshën 15-vjeçare, nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon atë për ta ndjekur shkollën. Ligji kërkon që fëmijët ndërmjet moshës 6 dhe 15-vjeçare ta vijojnë shkollimin.

Puna e fëmijës mbeti problem serioz. Sipas UNICEF-it, viteve të fundit numri i fëmijëve që punonin në rrugët e qyteteve ishte në rritje e sipër, ndonëse numri i përgjithshëm i fëmijëve që punonin mbeti i panjohur. Varfëria ishte shkaku më i rëndomtë që fëmijët të hynin në punë. Gjersa shumica e fëmijëve nuk ishin fituesit kryesorë të të ardhurave të familjes, puna e fëmijës shërbeu si ndihmë kryesore për shumë familje. Problemet me sistemin e shkollimit, përfshirë këtu cilësinë e ulët dhe mosvijimin e mësimit, i kontribuuan problemit të punës së fëmijës.

Në zonat rurale, fëmijët e rinj zakonisht u ndihmonin familjeve të veta në punë bujqësore. Fëmijët e qytetit shpesh punonin në një sërë punësh jozyrtare të shitjes me pakicë, si shitja e gazetave, cigareve dhe kartelave të telefonit në rrugë. Numri i fëmijëve të tillë që punonin në rrugë u rrit në krahasim me vitin 2007, ndonëse nuk pati të dhëna në dispozicion. Sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), qeveria nuk kishte vepruar për ta trajtuar këtë formë të rëndomtë të punës joformale të fëmijës. Disa fëmijë gjithashtu merreshin me punë fizike, si transportimi i mallrave. OJQ-të ndërkombëtare, që ishin aktive në vend, vazhduan të raportonin për shkelje të rënda të rregulloreve të punës gjatë këtij viti, përfshirë këtu punën e fëmijës. MPMS koordinoi politikën për mbrojtjen e fëmijëve, dhe Departamenti për mirëqenie sociale i MPMS-së ishte përgjegjës për ta siguruar mbrojtjen e fëmijëve. Ministria nuk kreu asnjë inspektim gjatë këtij viti.

e. Kushtet e pranueshme të punës

Nuk ka ligj që cakton rrogën minimale, dhe Kuvendi nuk miratoi asnjë ligj mbi punën gjatë këtij viti. Rroga mesatare mujore në Kosovë ishte 220 euro ($310) në sektorin publik dhe 275 euro ($388) në sektorin privat. Rroga minimale jozyrtare ishte 80 euro ($112). Ligji dhe rregulloret e UNMIK-ut parashikojnë javën standarde të punës prej 40 orësh; kërkojnë kohën e pushimit; kufizojnë numrin e orëve të rregullta të punës deri në 12 orë në ditë, kufizojnë punën jashtë orarit deri në 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj; kërkojnë pagimin e bonusit për punën jashtë orarit; dhe ndalojnë punën e tepërt të detyrueshme jashtë orarit. Punëdhënësit shpesh dështuan t'i respektonin këto rregullore për shkak të mungesës së zbatimit nga ana e qeverisë.

BSPK raportoi për shkelje të rënda të rregulloreve të punës gjatë këtij viti, përfshirë këtu mungesën e javës standarde të punës dhe punën e detyrueshme e të papaguar jashtë orarit; punëtorët nuk i raportonin shkeljet e tilla për shkak të frikës nga reprezaljet. Sipas BSPK-së, shumë individë punonin me orar të gjatë në sektorin privat kinse sipas dëshirës së punëtorëve pa kontratë pune, pa pagesë të rregullt, apo kontribute pensionale të paguara në emër të tyre. Punëtorët raportonin se përjashtoheshin nga puna pa arsye dhe në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe u mohoheshin festat. Organizatat për të drejtat e gruas treguan se abuzimi seksual ndodhte në vend të punës, por kalonte pa u raportuar për shkak të frikës nga përjashtimi apo hakmarrja fizike. Sipas zyrtarëve të sindikatës, punëtorët në sektorin publik zakonisht përballeshin me keqtrajtim të ngjashëm, përfshirë këtu abuzimin seksual dhe humbjen e vendit të punës për shkak të lidhjes me parti politike.

Një inspektorat i punës në kuadër të MPMS-së është përgjegjës për zbatimin e standardeve të punës. Megjithatë, inspektorati kryesisht i këshillonte punëdhënësit, dhe ndonëse shqiptoi 1,000 gjoba gjatë këtij viti për shkelje të ndryshme të standardeve të punës, ato nuk u paguan në pritje të procesit gjyqësor. Inspektorati i punës ishte përgjegjës për zbatimin e standardeve të shëndetit dhe sigurisë, por i mungonte personeli i trajnuar dhe nuk vepronte me efikasitet. Ligji nuk u lejon punëtorëve të largohen nga vendet e rrezikshme të punës pa e rrezikuar punësimin e tyre të vazhdueshëm.

Edhe pse ka ligj për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe të kushteve të tyre të punës, shumë institucione private e publike vazhduan ta shkelnin atë. Zyrtarët e inspektoratit të punës raportuan vështirësi në marrjen e informatave të sakta pasi punëtorët rrallë i zbulonin problemet vetë, përkundër mbrojtjeve ligjore.